



safejournalists.net

KOSOVË

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2025

Autori
Getoarbë Mulliqi



PËRMBAJTA

Rreth projektit

Shpjegim i treguesve

Shpjegim metodologjik

Treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve

LISTA E SHKURTESAVE

I Hyrje

II Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë – Treguesit

A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre

A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë

A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit rregullativ

A.3 Pavarësia dhe autonomia e mediave të shërbimit publik

A.4 Mbështetja financiare për gazetari cilësorë dhe përmbajtje mediatike me interes publik

A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e mediave private

A.6 Dispozitat ligjore që ndërlidhen me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekt dekurajues për gazetarët dhe median

A.7 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ua mundësojnë gazetarëve dhe akterëve të tjerë të medias të punojnë lirshëm dhe në mënyrë të sigurt.

A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet

A.9 Gazetarët janë të lirë ta ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, t'u bashkohen dhe të marrin pjesë në shoqatat e tyre

A.10 E drejta për qasje në dokumente dhe informacione zyrtare

B. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre

B.1 Pozitat e punës së gazetarëve janë të qëndrueshme dhe të mbrojtura në vendin e punës

B.2 Pavarësia editoriale në mediat private

B.3 Pavarësia editoriale në mediat e shërbimit publik

B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jofitimprurëse

B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

B.6 Pozita e punës së grave gazetare

C. Siguria e Gazetarëve

C.1 Gazetarët dhe akterët e mediave kanë qasje në masa mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive kur kërcënohen

C.2 Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie

C.3 Gratë gazetare kanë qasje në masa ligjore dhe mekanizma mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore.

C.4 Është krijuar praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

C.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

C.6 Njësitë e specializuara të hetimit dhe/ose oficerët janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

C.7 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe akterëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, të plotë dhe të shpejtë)

C.8 Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga format e ndryshme të ngacmimeve në internet

C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente.

C.10 Sistemet cilësore të mbledhjes së statistikave të krijuara nga autoritetet shtetërore për të ndaluar pandëshkueshmërinë

C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike

C.12 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

C.13 Sulmet aktuale

C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve

III Përfundime dhe rekomandime

IV Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Kosovë – 2025

Rreth projektit

SHPJEGIM I TREGUESVE

Shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetura nga Komisioni Evropian¹, kanë krijuar platformën [Safejournalists.net](https://safejournalists.net) për të monitoruar së bashku legjislacionin dhe praktikën e mediave në vendet e tyre dhe të angazhohen në avancimin e mjedisit ligjor dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave. Çdo vit, bazuar në një metodologji të hartuar me kujdes², partnerët e [Safejournalists.net](https://safejournalists.net) kryejnë kërkime avokuese që u kanë ofruar shoqatave të gazetarëve të dhëna të bazuara në prova, të besueshme dhe relevante për problemet dhe pengesat kryesore në zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë dhe sigurisë së mediave dhe gazetarëve në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet e hulumtimit të avokimit u japin përmbajtje aktiviteteve të partnerëve, duke u ofruar atyre prova dhe shembuj të rinj që përmirësojnë dhe forcojnë pozicionet e tyre të avokimit.

Mjeti i parë kualitativ i kërkimit – *Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve*, u zhvillua për herë të parë në vitin 2016 dhe u akordua gradualisht gjatë viteve. Ai përbëhet nga tre grupe treguesish: (A) Mbrojtja ligjore, (B) Pozicioni i gazetarëve në redaksi dhe (C) siguria e gazetarëve. Bazuar në këtë mjet monitorimi, janë publikuar gjithsej shtatë vlerësime, i fundit për vitin 2022.

Mjeti i kërkimit kuantitativ – *Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve*, u zhvillua në vitin 2020 dhe u testua në vitin 2021. Ai është krijuar për të 'matur' ndryshimet në mjedis që kanë ndikim të drejtpërdrejtë

1 Në dhjetor 2022, Komisioni Evropian miratoi një cikël të ri trevjeçar të Projektit [Safejournalists.net](https://safejournalists.net), i cili është vazhdim i dy fazave të mëparshme: projekti Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për mbrojtjen e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve (01.2016 – 12.2018) dhe Safejournalist.net (02.2020–03.2023). Objektivi kryesor i Projektit është fuqizimi dhe forcimi i rolit të shoqatave kombëtare të gazetarëve, anëtarë të Platformës [Safejournalists.net](https://safejournalists.net), të bëhen akterë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm në avokimin dhe krijimin e politikave përkatëse të mediave në vendet e tyre: Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Serbisë (IJAS), Asociacioni i Gazetarëve të BH (BHJ), Asociacioni i Gazetarëve Kroatë (CJA), Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë (AJM) dhe Sindikata e Mediave të Malit të Zi (TUMM). Projekti financohet nga Programi i BE-së për Shoqërinë Civile dhe Media në favor të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë për 2021-2023 (IPA III).

2 Hulumtimi për avokim është dizajnuar dhe koordinuar nga Snežana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë hulumtues të Institutit Kërkimor për Zhvillim Social RESIS, nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

ose të tërthortë në atë se sa të sigurt ndihen gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kur ushtrojnë profesionin e tyre. Ai përbëhet nga katër grupe treguesish: (1) Mjedisi ligjor dhe organizativ, (2) parandalimi i dhur, (3) Procesi i dhur dhe (4) Siguria aktuale. Bazuar në këtë mjet, u zbatuan gjithsej tri cikle kërkimore: 2020 (viti pilot), 2021 dhe 2022.

Duke filluar nga viti 2023, [Safejournalists.net](https://safejournalists.net) do të kombinojë dy mjetet e kërkimit (kualitativ dhe kuantitativ) në një projekt të vetëm kërkimor të avokimit – *Treguesit mbi nivelin e lirisë së mediave dhe Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve*. Platforma monitoron situatën në shtatë vende: Shqipëria, Bosna & Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova³ dhe Serbia.

SHPJEGIM METODOLOGJIK

I gjithë procesi i kërkimit është ndarë në dy faza: në *fazën e parë*, janë mbledhur të dhëna për të gjithë treguesit kualitativë – si për liritë e mediave ashtu edhe për sigurinë e gazetarëve, ndërsa në *fazën e dytë*, treguesit kualitativë për sigurinë e gazetarëve janë shndërruar në kuantitativë dhe është kryer procedura e pikëzimit dhe përlogaritjes së Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve.

Një sërë metodash të ndryshme kërkimi u aplikuan për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në lidhje me secilin tregues kualitativ specifik:

- Rishikimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza kualitative e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analiza e informacionit të publikuar në faqet e internetit të institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Marrja dhe analiza e njoftimeve për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës etj.;
- Fokus grupet me gazetarë, dhe
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

³ Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mendimin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.

Në nivel kombëtar, hulumtimi i avokimit është kryer nga studiues kombëtarë të cilët kryejnë mbledhjen e të dhënave dhe hartojnë raportet narrative, të cilat më pas u shqyrtuan nga mediat lokale dhe ekspertët ligjorë dhe nga hulumtuesi kryesor. Në Kosovë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës emëroi Getoarbë Mulliqin si hulumtuese kombëtare dhe Abit Hoxhën si ekspert të mediav, dhe Yll Zekajn si ekspert ligjor kombëtar për të shqyrtuar raportin.

TREGUESIT KUALITATIVË PËR NIVELIN E LIRISË SË MEDIAVE DHE SIGURISË SË GAZETARËVE

Tabela e mëposhtme paraqet të gjithë treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve, të ndarë në tri fusha. Këta tregues kualitativë paraqiten në formë përshkruese ose narrative. Një pjesë e treguesve që përdoren në kornizën konceptuale për Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve është shënuar me ngjyrë hiri në tabelë.

Pasqyrë e të gjithë treguesve kualitativë (Treguesit kualitativë për nivelin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve)

A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre	B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë themelore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë	B.1 Pozicioni i punës i gazetarëve është i qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	C.1 Gazetarët dhe aktorët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive
A.2 Pavarësia dhe efikasiteti i autoritetit rregullator	B.2 Pavarësia editoriale në mediat private	C.2 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie
A.3 Pavarësia dhe autonomia e shërbimit publik të mediave	B.3 Pavarësia editoriale në mediat e shërbimit publik	C.3 Gazetarët gra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore
A.4 Mbështetja financiare për gazetarinë cilësore dhe përmbajtjen mediatike me interes publik	B.4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jofitimprurëse	C.4 Është vendosur praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave
A.5 Reklamimi shtetëror në sektorin e mediave private	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	C.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve
A.6 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimi i tyre nuk krijojnë efekt ftohës për gazetarët dhe mediat	B.6 Pozita e punës së grave gazetare	C.6 Njësitë/zyrtarët e specializuar janë të pajisur me ekspertizë për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve
A.7 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt		C.7 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, tërësisht dhe menjëherë).
A.8 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet		C.8 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet.
A.9 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre		C.9 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente
A.10 E drejta për qasje në dokumente dhe informacione zyrtare		C.10 Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin
		C.11 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike

A. Masat mbrojtëse ligjore dhe zbatimi i tyre	B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
		C.12 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve
		C.13 Sulmet aktuale
		C.14 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve

INDEKSI I SIGURISË SË GAZETARËVE

Duke marrë parasysh standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare, koncepti i "sigurisë së gazetarëve"⁴ u funksionalizua duke marrë parasysh katër dimensionet e mëposhtme:

- I. **Mjedisi ligjor dhe organizativ** – ekzistenca dhe zbatimi i masave mbrojtëse ligjore të rëndësishme për sigurinë e gazetarëve.
- II. **Parandalimi i duhur** – ekzistenca dhe zbatimi i një sërë masash parandaluese që kanë efekte të drejtpërdrejta në mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve.
- III. **Procesi i rregullt** – sjellja e institucioneve shtetërore dhe zyrtarëve publikë ndaj gazetarëve dhe efikasiteti i sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me hetimin e kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve.
- IV. **Siguria aktuale** – incidente dhe raste të formave të ndryshme të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve dhe mediave.

Tabela e mëposhtme paraqet katër dimensionet dhe treguesit që përbëjnë modelin teorik të konceptit "siguria e gazetarëve". Të dhënat për të gjithë këta tregues u mbledhën në fazën e parë të hulumtimit, dhe në fazën e dytë, bazuar në dëshmitë e mbledhura kërkimore, nëntë anëtarë të Panelit Këshillimor nga secili prej vendeve⁵ vlerësuan situatën dhe caktoi pikë për secilin nga 19 treguesit:

4 Studiuesit nga Instituti RESIS (www.resis.mk), Snežana Trpevska, Igor Micevski dhe Ljubinka Popovska Toševa zhvilluan [kornizën konceptuale dhe metodologjike](#) për Indeksin dhe modelin për agregimin, peshimin dhe llogaritjen e tij.

5 Anëtarët e Panelit Këshillimor në Kosovë ishin: Imer Mushkolaj, Labinot Leposhtica, Mexhide Demolli, Jeton Mehmeti, Albana Rexha, Latif Mustafa, Sandra Cvetkovic, Florande Morina, Leonida Molliqaj.

Përmbledhje e treguesve në lidhje me Indeksin e Sigurisë së Gazetarëve

I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	II. Parandalimi i dhuri	III. Procesi i rregullt	IV. Siguriareale aktuale
1.1 Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekt ftohës për gazetarët dhe mediat	2.1 Gazetarët dhe akterët e mediave kanë qasje në masat mbrojtëse të menjëhershme dhe efektive	3.1 Njësitë/zyrtarët e specializuar janë të pajisur me ekspertizë për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	4.1 Kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike
1.2 Konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është i garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	2.2 Gazetarët dhe akterët e tjerë të mediave kanë qasje në mekanizma të posaçëm mbrojtjeje ose sigurie	3.2 Hetimet e sulmeve të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, tërësisht dhe menjëherë).	4.2 Kërcënime ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve
1.3 Ligjet e tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe u mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	2.3 Gazetarët gra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetës	3.3 Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efikase nga forma të ndryshme të ngacmimeve në internet.	4.3 Sulmet aktuale
1.4 Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të krijojnë, anëtarësohen dhe marrin pjesë në shoqatat e tyre	2.4 Praktika e dënimit të rregullt publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	3.4 Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente	4.4 Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve
1.5 Pozicioni i punës i gazetarëve është i qëndrueshëm dhe i mbrojtur në vendin e punës	2.5 Autoritetet policore janë të ndjeshme ndaj çështjeve të mbrojtjes së gazetarëve	3.5 Sistemet e grumbullimit të statistikave cilësore të krijuara nga autoritetet shtetërore për të frenuar mosndëshkimin	

Vërejtje: Kur në këtë raport përdoret gjinia mashkullore, ajo gjithmonë i referohet njëkohësisht femrave, meshkujve dhe individëve të ndryshëm. Format e ndryshme nuk janë përdorë për hir të lexueshmërisë më të mirë.

LISTA E SHKURTESAVE

AGK – Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

AIP – Agjencia për Informim dhe Privatësi

BE – Bashkimi Evropian

BIRN – Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese

IKD – Instituti i Kosovës për Drejtësi

KALLXO – KALLXO.com (Platforma e Gazetarisë Hulumtuese)

KDI – Instituti Demokratik i Kosovës

KE – Komisioni Evropian

KEDNj – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KPM – Komisioni i Pavarur i Medieve

MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

MPM – Monitori i Pluralizmit në Media

OJQ – Organizatë Joqeveritare

OKB – Kombet e Bashkuara

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PSM – Media e Shërbimit Publik

RTK – Radio Televizioni i Kosovës

SLAPP – Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike

UN Women – Programi i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave



Hyrje

Kosova është një republikë demokratike parlamentare, me një ndarje të qartë të pushteteve midis legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Presidenti shërben si kreu i shtetit, ndërsa kryeministri udhëheq qeverinë. Kuvendi i Kosovës ka 120 vende, me 20 të rezervuara për komunitetet jo-shumicë, duke përfshirë 10 për komunitetin serb dhe pjesën tjetër për boshnjakët, turqit, romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët. Kosova mbetet një shoqëri multietnike, me shqiptarët që përbëjnë popullsinë shumicë, ndërsa komunitetet minoritare gëzojnë të drejta kulturore, gjuhësore dhe politike të garantuara me kushtetutë. Pavarësisht këtyre garancive formale, kultura politike vazhdon të formësohet nga elemente të klientelizmit, patronazhit politik dhe perceptimeve të korrupsionit, të cilat ndikojnë në funksionimin institucional dhe besimin publik. Këto dinamika ndikojnë gjithashtu në sektorin e medias, ku edhe shpesh ndërthuren presionet politike dhe ekonomike.

Mjedisi politik në Kosovë gjatë vitit 2025 mbeti tejet i polarizuar, me tensione të vazhdueshme midis institucioneve qeveritare dhe mediave kritike. Sfera publike është karakterizuar gjithnjë e më shumë nga diskurset armiqësore ndaj gazetarëve, duke përfshirë sulmet verbale, delegjitimizimin e medias dhe përpjekjet për ta paraqitur raportimin kritik si të motivuar politikisht ose të anshëm. Disa raste të dokumentuara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës tregojnë një model presioni, veçanërisht nga zyrtarët publikë. Në të njëjtën kohë, Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2025 vë në pah se Kosova nuk ka bërë përparim në fushën e lirisë së shprehjes, ndërsa thekson shqetësimet që lidhen me presionin politik, reagimet e dobëta institucionale ndaj sulmeve kundër gazetarëve dhe sfidat në funksionimin e organeve rregullative të medias. Zhvillime të tilla si kriza institucionale brenda Komisionit të Pavarur të Medieve (KPM), duke përfshirë mungesën e kuorumit dhe mosmarrëveshjet për qeverisjen, ilustrojnë më tej brishtësinë e strukturave të mbikëqyrjes së medias. Në këtë kontekst, gazetarët veprojnë në një mjedis ku tensionet politike ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e tyre profesionale dhe pavarësinë redaktoriale.

Kushtet ekonomike të Kosovës vazhdojnë të paraqesin sfida strukture për sektorin e medias. Edhe pse vendi ka kapërcyer nëpër një rritje mesatare ekonomike, mbetet i karakterizuar nga një treg i vogël, investime të kufizuara publike dhe varësi e lartë nga remitencat. Sektori i medias, në veçanti, përballet me kufizime të konsiderueshme financiare. Nuk ka sistem gjithëpërfshirës të mbështetjes shtetërore për mediat e pavarura, përveç transmetuesit publik RTK-së, i cili financohet përmes buxhetit të shtetit. Shumica e mediave private mbështeten shumë në të ardhurat nga reklamat digjitale të dominuara nga platforma globale si Google dhe Meta, si dhe në financimin e bazuar në projekte nga donatorë ndërkombëtarë. Ky model i brishtë financiar kontribon në kushte të pasigurta pune për gazetarët, duke përfshirë paga të ulëta, vonesa të pagave, kontrata afatshkurtra dhe qasje të kufizuara në mbrojtje sociale. Presionet ekonomike ndikojnë gjithashtu në praktikat editoriale, pasi mediat shpesh i japin përparësi mbijetesës financiare mbi investimet në gazetarinë hulumtuese, duke rritur rreziqet e vetëcensurës dhe duke ulur cilësinë e përgjithshme të raportimit me interes publik.

Kosova ka një mjedis mediatik pluralist, por të fragmentuar, i karakterizuar nga një numër i madh televizioneesh, radiosha dhe mediash online. Që nga viti 2020, mediat e shkruara janë zhdukur në mënyrë efektive, ku të gjitha gazetatat kryesore kanë kaluar në platforma digjitale. Sektori përfshin një përzierje të mediave komerciale, transmetimeve të shërbimit publik dhe një numër më të vogël mediash jofitimprurëse ose të mbështetura nga donatorët. Transmetuesi publik, RTK, operon disa kanale televizive dhe radiofonike dhe ofron programe në gjuhët e minoriteteve; megjithatë, pavarësia e RTK-së vazhdon të vihet në pikëpyetje për shkak të ndikimit politik dhe strukturave të paqëndrueshme të qeverisjes. Korniza rregullative përfshin Komisionin e Pavarur të Medieve (KPM) si autoritetin kryesor rregullativ për mediat audiovizuale dhe Këshillin e Mediave të Shtypura të Kosovës si një organ vetërregullues për mediat e shkruara dhe online.

Sa i përket zhvillimeve ligjore, viti 2025 u karakterizua nga debate të vazhdueshme mbi pavarësinë dhe funksionimin e KPM-së. Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitat kryesore të Ligjit për KPM-në, duke përmendur rreziqet për pavarësinë institucionale, veçanërisht në lidhje me emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit. Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian theksoi shqetësimet në lidhje me presionin politik mbi organet rregullative, zbatimin e dobët të legjislacionit dhe mungesën e mbikëqyrjes efektive gjatë periudhave zgjedhore, duke përfshirë dështimin për t'i adresuar shkeljet e mediave për shkak të mungesës së kuorumit. Edhe pse korniza ligjore e Kosovës garanton zyrtarisht lirinë e shprehjes dhe qasjen në informata, zbatimi mbetet i paqëndrueshëm. Gazetarët vazhdojnë të përballen me pengesa të tilla si vonesat në qasje në dokumente publike, mungesa e transparencës në institucionet publike dhe mbrojtja e mangët nga ngacmimi dhe frikësimi.

Në përgjithësi, mjedisi mediatik i Kosovës në vitin 2025 pasqyron një kombinim të garancive formale ligjore dhe sfidave të vazhdueshme praktike. Polarizimi politik, cenueshmëria ekonomike dhe dobësitë institucionale vazhdojnë t'i formësojnë kushtet në të cilat veprojnë gazetarët, duke ndikuar si në sigurinë e tyre ashtu edhe në cilësinë e gazetarisë në vend.



Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë – Treguesit

A. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

— A.1 GARANCITË THEMELORE PËR LIRINË E MEDIAVE DHE GAZETARËVE DHE ZBATIMI I TYRE NË PRAKTIKË

Korniza ligjore në Kosovë vazhdon të ofrojë një bazë të fortë për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë dhe përparësinë e instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), neni 10 i së cilës garanton lirinë e shprehjes.⁶ Kushtetuta garanton më tej lirinë e informimit dhe lirinë e shtypit, të cilat interpretohen gjerësisht për të përfshirë të drejtën për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informata, duke përfshirë edhe përmes platformave digjitale dhe internetit.⁷ Legjislacioni plotësues—siç është Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligji për Qasjen në Dokumente Publike dhe Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve, i përforcon këto garanci dhe ofron mekanizma për mbrojtjen e punës gazetareske dhe qasjen në informata⁸.

Megjithatë, në praktikë, zbatimi i këtyre garancive vazhdon të hasë në sfida, veçanërisht në lidhje me ndikimin politik mbi institucionet rregullatore dhe nismat legjislative që ndikojnë në sektorin e mediave. Gjatë vitit 2025, nuk ka pasur raste të ditura në të cilat autoritetet shtetërore u përpoqën të bllokoinin ose filtronin përmbajtjen e internetit ose të kufizonin qasjen publike në internet. Qasja në internet mbetet kryesisht e pakufizuar dhe mediat online vazhdojnë të operojnë lirisht në sferën digjitale⁹.

6 [Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22](#); [Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 10](#).

7 [Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 40 dhe 42](#).

8 [Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë](#); [Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike](#); [Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave](#).

9 [Freedom House](#) Liria në Internet – Kosova; dhe dëshmitë e gazetarëve të mbledhura përmes grupeve të fokusit me profesionistë të mediave në Kosovë, 2025.

Zhvillimi më i rëndësishëm që ndikoi në kornizën ligjore të mediave në vitin 2025 kishte të bënte me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës në korrik 2024.¹⁰ Ligji kishte futur dispozita të reja rregullative duke përfshirë kërkesat për licencim për mediat online që prodhojnë dhe publikojnë përmbajtje me video, duke zgjeruar në mënyrë efektive autoritetin e KPM-së përtej transmetuesve tradicionalë audiovizualë. Këto dispozita ngritën shqetësime në mesin e organizatave mediatike, grupeve të shoqërisë civile dhe akterëve ndërkombëtarë, të cilët paralajmëruan se kërkesa të tilla mund të çonin në rritjen e mbikëqyrjes shtetërore mbi mediat digjitale dhe potencialisht të kufizonin pluralizmin e medias.¹¹ Në prill të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shfuqizoi Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave pasi konstatoi se disa nga dispozitat e tij nuk ishin në pajtim me Kushtetutën, veçanërisht ato që lidheshin me zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të KPM-së, fushëveprimin e kompetencave të tij dhe mekanizmat sanksionues të parashikuar me ligj.¹² Komentet e dorëzuara nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) përbënin një kontribut të rëndësishëm në procesin e shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese.¹³ Vendimi i Gjykatës theksoi rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë institucionale të rregullatorit të medias dhe garantimit që legjislacioni që ndikon në sektorin e mediave të jetë në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe pluralizmit. Vendimi u mirëprit nga organizatat e mediave dhe shoqëria civile, të cilat më parë e kishin kritikuar procesin legjislativ për mungesë transparence dhe konsultimi kuptimplotë me akterët përkatës.¹⁴ Gjykata gjithashtu theksoi se çdo iniciativë legjislative e ardhshme që synon reformimin e kornizës së të KPM-së duhet të sigurojë përfshirje më të gjerë dhe konsultime thelbësore me përfaqësuesit e medias dhe akterët e tjerë.

Mediave me bazë në internet ende nuk u duhet të marrin licencë paraprake shtetërore dhe tregu i mediave mbetet relativisht i arritshëm. Megjithatë, debati rreth ligjit të ri të KPM-së tregon një tendencë në zhvillim drejt rregullimit më strikt të medias online, gjë që ka ngritur shqetësime në mesin e shoqatave të gazetarëve dhe shoqërisë civile në lidhje me rrjedhojat e mundshme për lirinë e mediave.

— A.2 PAVARËSIA DHE EFIKASITETI I AUTORITETIT RREGULLATIV

Autoriteti kryesor përgjegjës për rregullimin e sektorit të mediave audiovizuale në Kosovë është Komisioni i Pavarur i Mediave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton KPM-në si një organ të pavarur përgjegjës për licencimin, rregullimin dhe monitorimin e aktiviteteve të transmetimit (Neni 141). Mandati i tij përcaktohet më tej nga Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji Nr. 04/L-044).¹⁵, i cili

10 Kuvendi i Republikës së Kosovës. [Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave](#), miratuar në korrik 2024.

11 [Deklaratë e koalicionit për Reagim të Shpejtë për Lirinë e Mediave mbi ligjin e mediave në Kosovë dhe shqetësimet rreth ndikimit politik mbi rregullatorin e medias.](#)

12 [Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave](#), Prill 2025.

13 [AGK ia dorëzon Gjykatës Kushtetuese komentet mbi Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave](#), Gusht, 2024.

14 [Reagime dhe deklarata nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile në lidhje me ligjin e KPM-së dhe nevojën për konsultime gjithëpërfshirëse legjislative.](#)

15 [LIGJI NR. 04/L-044 PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE.](#)

ofron kornizën ligjore për mbikëqyrjen e mediave audiovizuale, sigurimin e pajtueshmërisë me standardet e transmetimit dhe caktimin e masave administrative kur ndodhin shkelje.

Sipas kornizës ligjore, anëtarët e KPM-së zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës përmes procedurave të hapura, transparente dhe të bazuara në meritë. Në parim, këto procedura pasqyrojnë standardet demokratike që synojnë mbrojtjen e pavarësisë së autoritetit rregullativ. Megjithatë, në praktikë, ka shqetësime në lidhje me ndikimin politik në procesin e emërimit.¹⁶ Organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertët e mediave kanë theksuar vazhdimisht mungesën e kriterëve të qarta të vlerësimit dhe debatin e kufizuar publik mbi kualifikimet e kandidatëve.¹⁷ Gjithashtu, lidhur me çështjen e Ligjit të ri për KPM-në, IKD publikoi raportin “Politizimi i KPM-së”, i cili konstatoi se pavarësia e garantuar nga Kushtetuta për një institucion të pavarur siç është KPM-ja po transformohet në një varësi të këtij institucioni nga partia në pushtet. Ndër të tjera, raporti trajtoi procedurën e shkarkimit dhe bazat për shkarkimin e anëtarëve të KPM-së.¹⁸

Zhvillimet gjatë vitit 2025 i nxorën në pah më tej këto mangësi. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën theksoi sfidat e vazhdueshme të qeverisjes brenda KPM-së, duke përfshirë vështirësitë në ushtrimin e mandatit të saj rregullator për shkak të paqëndrueshmërisë institucionale dhe presionit politik.¹⁹ Për më tepër, vonesat në emërime rezultuan që KPM të funksiononte pa përbërje të plotë, gjë që ndikoi ndjeshëm në punën e saj. Në fillim të vitit 2025, Komisionit i mungonte kuorumi i nevojshëm për vendimmarrje, ndërsa Bordi i Ankesave kishte mbetur pa kuorum që nga nëntori i vitit 2023, duke ngritur shqetësime serioze në lidhje me efektivitetin institucional dhe mbikëqyrjen demokratike.²⁰

Në parim, KPM-ja ka mandatin të veprojë në mënyrë të pavarur nga interesat politike dhe komerciale. Megjithatë, raportimet si vendore ashtu edhe ndërkombëtare tregojnë se kjo pavarësi mbetet e brishtë në praktikë.²¹ Një zhvillim i rëndësishëm në vitin 2025 ishte vendimi i Gjykatës Kushtetuese për ta shfuqizuar Ligjin e ri për KPM-në, duke konstatuar se dispozitat që lidhen me emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve nuk janë në pajtim me Kushtetutën, pasi ato rrezikonin të minonin pavarësinë e rregullatorit.²²

Për më tepër, ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të Punës së KPM-së mundësuan zëvendësimin e Kryesuesit para përfundimit të mandatit, një veprim që u kritikua gjerësisht për mungesë transparence dhe potencialisht për mundësimin e ndërhyrjes politike. Organizatat e shoqërisë civile, përfshirë Institutin e Kosovës për Drejtësi²³, kanë argumentuar se procedurat ekzistuese të emërimit dhe shkarkimit rrezikojnë ta transformojnë

16 Intervistë me Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Intervistoi Gëtoarbë Mulliqi, 14.01.2026.

17 Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Raporti [Politizimi i KPM-së](#); Betimi për Drejtësi.

18 Po aty.

19 [Çfarë thotë për KPM-në raporti i Komisionit Evropian për Kosovën?](#) 5 nëntor 2025

20 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën](#), Nëntor 2025.

21 Intervistë me Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Intervistoi Gëtoarbë Mulliqi, 14.01.2026.

22 [Vendimi i Gjykatës Kushtetuese hap rrugën për forcimin e pavarësisë së rregullatorit të medias](#)

23 Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Raporti [Politizimi i KPM-së](#); Betimi për Drejtësi

KPM-në në një organ të varur nga shumica parlamentare, duke dobësuar kështu pavarësinë e tij kushtetuese.

KPM-ja vazhdon të administrojë procedurat e licencimit për transmetuesit audiovizualë dhe shumica e mediave operojnë sipas licencave valide. Megjithatë, ka ende shqetësime në lidhje me qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e zbatimit rregullativ. Sipas Komisionit Evropian, KPM-ja dështoi të veprojë ndaj shkeljeve të mediave gjatë fushatës zgjedhore për shkak të mungesës së kuorumit për vendimmarrje.²⁴ Për më tepër, reagimi i Komisionit ndaj dezinformimit në kohë zgjedhjesh dhe ndërhyrjes së huaj u vlerësua si i mangët. Në përgjithësi, edhe pse korniza ligjore parashikon një rregullator të pavarur, performanca e KPM-së në vitin 2025 u kufizua ndjeshëm nga dështimet në qeverisje, presionet politike dhe paraliza institucionale, duke ngritur shqetësime serioze në lidhje me aftësinë e saj për të vepruar në mënyrë plotësisht të pavarur, efikase dhe neutrale.

— A.3 PAVARËSIA DHE AUTONOMIA E MEDIAVE TË SHËRBIMIT PUBLIK

Autonomia dhe pavarësia e medias së shërbimit publik të Kosovës janë zyrtarisht të garantuara në legjislacion, por në praktikë mbeten vetëm pjesërisht të mbrojtura. Ligji për Radiotelevizionin e Kosovës e përcakton Radiotelevizionin e Kosovës si një transmetues të pavarur të shërbimit publik me mandat për të ofruar program të balancuar, të paanshëm dhe të larmishëm në interes të publikut.²⁵ Ligji e përcakton Bordin e RTK-së si organin mbikëqyrës përgjegjës për ruajtjen e pavarësisë redaktoriale dhe mbikëqyrjen e funksionimit të institucionit.²⁶ Në parim, korniza ligjore parashikon gjithashtu mekanizma llogaridhënieje, duke përfshirë komentet publike dhe detyrimin për të reflektuar diversitetin e shoqërisë së Kosovës. Megjithatë, shqetësime të vazhdueshme në lidhje me ndikimin politik vazhdojnë të ngrihen nga shoqëria civile dhe organet ndërkombëtare të monitorimit. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën i vitit 2025 vë në dukje se nuk është bërë asnjë përparim në forcimin e lirisë së medias, ndërsa sfidat e qeverisjes brenda RTK-së, duke përfshirë vendet e lira të punës dhe paqëndrueshmërinë institucionale, e kanë dobësuar pavarësinë e saj në praktikë.²⁷ Në mënyrë të ngjashme, shoqëria civile në Kosovë thekson se pavarësia redaktoriale është e ndjeshme ndaj presioneve politike dhe menaxheriale, veçanërisht në kontekste ku strukturat qeverisëse janë të paqëndrueshme.

Modeli i financimit të RTK-së mbetet dobësi kryesore strukturore. Transmetuesi vazhdon të mbështetet kryesisht në alokimet vjetore nga buxheti i shtetit, në vend të një modeli të qëndrueshëm financimi siç është sistemi i tarifës së licencës. Edhe pse parashikohet si zgjidhje e përkohshme në ligj, ky rregullim është bërë në fakt i përhershëm. Kjo krijon pasiguri

24 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

25 Intervistë me Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, Intervistoi Gëtoarbë Mulliqi, 14.01.2026

26 [Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Gazeta Zyrtare](#)

27 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

financiare dhe ekspozim të mundshëm ndaj ndikimit politik, pasi financimi varet nga vendimet vjetore të Kuvendit.

Si Komisioni Evropian ashtu edhe organizatat rajonale për monitorim të mediave theksojnë se Kosova ende nuk ka siguruar ndonjë mekanizëm financimi të qëndrueshëm dhe të pavarur për RTK-në.²⁸ Gjatë vitit 2025, pasojat e këtij modeli të brishtë financimi u shpërfaqën në masë të madhe, pasi gazetarët dhe punonjësit e mediave së RTK-së mbetën pa paga në dy raste të ndryshme gjatë vitit. Sipas raportimeve nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare, vonesat në shpërndarjen e fondeve buxhetore çuan në ndërprerje të pagave, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë financiare të punonjësve.²⁹ Këto incidente nxorën në pah më tej cenueshmërinë e transmetuesit ndaj joefikasiteteve institucionale dhe politike, duke përforcuar shqetësimet se sistemi aktual i financimit jo vetëm që minon pavarësinë redaktoriale, por rrezikon edhe të drejtat themelore të punës brenda transmetuesit të shërbimit publik.³⁰

Sfidat në qeverisjen institucionale kanë ndikuar në funksionimin e RTK-së në vitet e fundit. Bordi i RTK-së ka përjetuar vështirësi në funksionimin efektiv për shkak të vendeve të lira dhe vonesave në emërimin e anëtarëve të rinj pas dorëheqjeve në vitin 2024. Si rezultat, te organi mbikëqyrës ndonjëherë ka munguar kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime, duke kufizuar aftësinë e tij për të ushtruar mbikëqyrje efektive mbi transmetuesin publik. Sipas Komisionit Evropian, Bordi i RTK-së nuk kishte kuorum pas vendeve të lira të punës, duke kufizuar aftësinë e tij për të ushtruar mbikëqyrje efektive.³¹ Kjo paralizë institucionale dobësoi më tej mekanizmat e llogaridhënies brenda transmetuesit publik. Për më tepër, konsultimet e rregullta me shoqërinë civile mbi programin dhe politikat redaktoriale mbeten të kufizuara. Raportet e monitorimit tregojnë se angazhimi me publikun nuk është sistematik dhe mekanizmat për pjesëmarrje kuptimplotë janë të pazhvilluara. Në përgjithësi, edhe pse korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me standardet evropiane, mangësitë praktike, veçanërisht qeverisja e politizuar, financimi i paqëndrueshëm dhe angazhimi i dobët publik, vazhdojnë të minojnë pavarësinë dhe autonominë efektive të mediave të shërbimit publik.³²

— A.4 MBËSHTETJA FINANCIARE PËR GAZETARI CILËSORE DHE PËRMBAJTJE MEDIATIKE ME INTERES PUBLIK

Kosova aktualisht nuk ka sistem specifik të subvencioneve shtetërore të hartuara për ta mbështetur sektorin e medias së shkruar. Kjo lidhet ngushtë me transformimin strukturor të peizazhit mediatik të vendit gjatë dekadës së fundit. Që nga marsi i vitit 2020, Kosova nuk ka pasur më gazeta të shtypura të botuara rregullisht, pasi të gjitha mediat kryesore që më parë funksiononin në formë të shtypur kanë kaluar

28 Po aty.

29 [Kosovë: FEG dhe partnerët i kërkojnë qeverisë ta publikojë buxhetin e RTK-së dhe ta mbrojë lirinë e medias.](#)

30 Intervistë me Xhemajl Rexhën, Kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, intervistuar nga Gëtoarbë Mulliqi, 28.12.2025.

31 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

32 Intervistë me Xhemajl Rexhën, Kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, intervistuar nga Gëtoarbë Mulliqi, 28.12.2025.

tërësisht në platforma online. Ish-gazetat e përditshme si Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot, Epoka e Re dhe Bota Sot tani funksionojnë ekskluzivisht si media digjitale.

Zhdukja e medias së shkruar u përshpejtua gjatë pandemisë COVID-19, por kryesisht erdhi si pasojë e sfidave financiare afatgjata, duke përfshirë rënien e lexueshmërisë, tkurrjen e të ardhurave nga reklamat dhe kostot e larta që lidhen me shtypjen dhe shpërndarjen. Si rezultat, korniza ligjore dhe e politikave të Kosovës aktualisht nuk ofron subvencione ose stimuj financiarë për mediat e shkruara.

Në përgjithësi, Kosovës i mungon një fond kombëtar i dedikuar për pluralizmin e mediave ose gazetarinë me interes publik. Mediat varen kryesisht nga të ardhurat komerciale dhe financimi i donatorëve bazuar në projekte. Kjo krijon dobësi strukturore, veçanërisht pasi tregu i reklamave digjitale dominohet nga platformat globale. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën³³ thekson se qëndrueshmëria financiare mbetet sfida kryesore për sektorin e medias, pa një politikë gjithëpërfshirëse në vend për të mbështetur gazetarinë e pavarur. Në praktikë, kjo do të thotë që shumë media varen ndjeshëm nga tregjet e reklamave digjitale të dominuara nga platforma globale si Google dhe Meta, të cilat një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave e sigurojnë nga reklamat online.

Partnerët ndërkombëtarë vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e gazetarisë cilësore dhe zhvillimit të mediave në Kosovë. Iniciativa të ndryshme të financuara nga organizata të tilla si Bashkimi Evropian, fondacione ndërkombëtare dhe ambasadat e huaja ofrojnë grante, trajnime dhe mbështetje të bazuar në projekte për gazetarinë hulumtuese, inovacionin mediatik dhe zhvillimin profesional. Megjithatë, mungesa e një mekanizmi financimi të administruar në nivel kombëtar dhe transparent do të thotë që mbështetja financiare mbetet e fragmentuar dhe kryesisht e varur nga ndihma e jashtme sesa nga politika shtetërore e institucionalizuar.³⁴

Mediat në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida serioze të qëndrueshmërisë dhe në përgjithësi mbështeten më tepër në ndihmën e donatorëve të bazuar në projekte sesa në një sistem të qëndrueshëm financimi publik. Edhe pse Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025 thekson se qeveria miratoi programin e Zyrës për Çështje të Komuniteteve brenda Zyrës së Kryeministrit, duke mundur mbështetje financiare për shoqërinë civile dhe mediat që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë³⁵, ky mekanizëm financimi nuk është i përhershëm ose gjithëpërfshirës. Në praktikë, mbështetja mbetet e fragmentuar dhe vjetore, në vend që të institucionalizohet. Sipas raportimeve, Zyra për Çështjet e Komuniteteve deklaroi se tetë media përfituan në vitin 2023 dhe pesë në vitin 2024, ndërsa për vitin

33 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

34 [Barometri i Informimit të Pastër i Kosovës 2024](#)

35 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

2025 asnjë program nuk ishte miratuar në kohën e raportimit.³⁶ Në përgjithësi, mediat e komuniteteve minoritare vazhdojnë të përballen me mungesë të burimeve të qëndrueshme financiare.

— A.5 REKLAMIMI SHTETËROR NË SEKTORIN E MEDIAVE PRIVATE

Kosova nuk ka kornizë ligjore gjithëpërfshirëse që i rregullon reklammat shtetërore në mediat private³⁷, dhe praktika mbetet e kufizuar dhe kryesisht e pastrukturuar. Institucionet publike komunikojnë kryesisht përmes faqeve zyrtare të internetit, njoftimeve për shtyp dhe kanaleve të mediave sociale në vend që të blejnë sistematikisht hapësirë reklamuese në mediat private. Si rezultat, reklama shtetërore nuk është zhvilluar si një instrument formal politikash dhe nuk ka legjislacion të dedikuar që përcakton kritere për ndarjen, monitorimin ose raportimin. Teksa transmetuesi i shërbimit publik (RTK) merr fonde të rregullta nga buxheti i shtetit, mediat private mbështeten pothuajse tërësisht në të ardhurat komerciale dhe mbështetjen e donatorëve, gjë që rrit cenueshmërinë e tyre financiare. Vërehet se sektori i mediave vazhdon të përballlet me sfidën e qëndrueshmërisë³⁸, pjesërisht për shkak të mungesës së mekanizmave të strukturuar dhe transparentë të financimit publik³⁹.

Duke pasur parasysh fushëveprimin e kufizuar të reklamave shtetërore, ka pak raste të dokumentuara të ndarjes sistematike të fondeve të reklamave publike në mediat private. Raportet e monitorimit tregojnë se procedurat e përzgjedhjes nuk janë gjithmonë të përcaktuara publikisht, duke e bërë të vështirë vlerësimin nëse ndarjet buxhetore janë jodiskriminuese. Ato identifikojnë një rrezik të mesëm në këtë fushë, duke theksuar se mbrojtjet e dobëta rregullative dhe transparenca e kufizuar mund të mundësojnë ndikim indirekt.⁴⁰ Shpenzimet e institucioneve publike për komunikimin në lidhje me median gjithashtu nuk janë të rregulluara ose të standardizuara në mënyrë të vazhdueshme, gjë që mund të ndikojë në qasjen e barabartë për media të ndryshme.⁴¹ Provat nga viti 2025 tregojnë se ndërmarrjet shtetërore vazhdojnë të veprojnë si financues indirektë të mediave private. Sipas raportimeve të mediave, Posta dhe Telekom i Kosovës nënshkroi kontrata reklamimi dhe shërbimesh me vlerë mbi 230,000 euro me disa media.⁴² Praktika të tilla tregojnë se fondet publike kanalizohen në mediat private përmes marrëveshjeve tregtare, në mungesë të një kornize transparente dhe të rregulluar për reklammat shtetërore.

Edhe pse nuk ka prova të forta për abuzim sistematik të reklamave shtetërore për ndikim politik, mungesa e rregullave dhe mekanizmave mbikëqyrës përfaqëson

36 [Zëra të ndryshëm, probleme të njëjta: Kriza e mediave ndërkomunitare në Kosovë – Më pak dyer të hapura dhe fonde të reduktuara.](#)

37 [Barometri i Informimit të Pastër i Kosovës 2024](#)

38 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

39 Intervistë me Flutura Kusarin, juriste për media, intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 28.12.2025.

40 Po aty.

41 [Forcimi i Rolit dhe Kapaciteteve të Gazetarisë Hulumtuesenë Kosovë](#)

42 [Me sa duket "skandali nuk ka të ndalur" – Telekom i Kosovës nënshkruan kontrata me vlerë mbi 200 mijë euro me disa media.](#)

një rrezik strukturor, veçanërisht në një kontekst ku qëndrueshmëria e medias është e brishtë.

Duke u bazuar në mungesën e një kornize të qartë dhe të rregulluar për reklamat shtetërore, transparencë në lidhje me shpenzimet publike për komunikimin në media mbetet gjithashtu e kufizuar në Kosovë. Institucionet publike nuk publikojnë sistematikisht të dhëna mbi shumën e shpenzuara për reklamat në media, dhe as nuk zbulojnë rregullisht se cilat media marrin fonde të tilla. Si rezultat, nuk ka bazë të dhënash gjithëpërfshirëse dhe të qasshme publikisht që do të lejonte ndjekjen efektive të shpenzimeve qeveritare për promovimin e medias. Është vënë re se ka mangësi të vazhdueshme në transparencë dhe llogaridhënie në sektorin e medias, duke përfshirë zbulimin dhe mbikëqyrjen e kufizuar financiare.⁴³ Raporti i IREX VIBE thekson më tej transparencën e dobët financiare dhe dobësitë strukturore që ndikojnë në qëndrueshmërinë e mediave.⁴⁴ Analizat e mëparshme nga organizatat e monitorimit të mediave kanë theksuar vazhdimisht nevojën për standarde më të qarta raportimi mbi buxhetet e komunikimit publik dhe masa mbrojtëse më të forta për të siguruar ndarje të drejtë buxhetore. Forcimi i kërkesave për transparencë dhe vendosja e rregullave të qarta për shpërndarjen e fondeve të reklamave publike do të rriste llogaridhënien dhe do të zvogëlonte rrezikun e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në sektorin e mediave.

— A.6 DISPOZITAT LIGJORE QË NDËRLIDHEN ME SHPIFJEN DHE ZBATIMIN E TYRE NUK KRIJOJNË EFEKT DEKURAJUES PËR GAZETARËT DHE MEDIAN

Shpifja në Kosovë rregullohet nga Kodi Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Ligji Nr. 02/L-65)⁴⁵, i miratuar në vitin 2007. Ligji dekriminalizon shpifjen dhe e trajton atë si një çështje civile, gjë që në përgjithësi e harmonizon kornizën ligjore të Kosovës me standardet evropiane mbi lirinë e shprehjes, veçanërisht ato të zhvilluara përmes jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Këshillit të Evropës. Është e rëndësishme të theksohet se ligji parashikon qartazi që institucionet publike dhe autoritetet shtetërore nuk mund të iniciojnë padi për shpifje në cilësinë e tyre zyrtare, gjë që konsiderohet një mbrojtje e rëndësishme për lirinë e shprehjes dhe shqyrtimin publik të veprimeve qeveritare. Ligji parashikon kompensimin civil si mjetin kryesor juridik në rastet e shpifjes dhe kërkon që dëmet të jenë në përpjesëtim me dëmin e shkaktuar. Gjykatat pritet të balancojnë mbrojtjen e reputacionit me interesin publik në debatin e hapur, veçanërisht kur raportimi ka të bëjë me zyrtarë publikë ose çështje me interes publik. Ekspertët e ligjit të mediave në përgjithësi i konsiderojnë vetë dispozitat ligjore si kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, ende ekzistojnë shqetësime në lidhje me përdorimin praktik të padive për shpifje nga individë me ndikim si një mjet i mundshëm për të dekurajuar raportimin kritik.⁴⁶

43 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

44 [Barometri i Informimit të Pastër i Kosovës 2024](#)

45 LIGJI NR. 02/L-65 E DREJTA CIVILE KUNDËR SHPIFJES DHE FYERJES <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2503&langid=2>

46 Intervistë me Yll Zekaj, avokat dhe përfaqësues ligjor i AGK-së, Intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 15.01.2026.

Sipas të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në vitin 2024 në Kosovë u ngritën gjithsej 132 padi për shpifje. Megjithatë, të dhënat publike nuk specifikojnë se sa prej këtyre rasteve u iniciuan nga politikanë ose zyrtarë të tjerë publikë. Kjo mungesë e informatave të ndara e bën të vështirë vlerësimin e shkallës në të cilën paditë për shpifje përdoren nga akterët politikë ose individë të tjerë me ndikim kundër gazetarëve.

Në vitet e fundit, disa raste që përfshijnë figura publike ose individë të njohur kanë tërhequr vëmendjen e organizatave për lirinë e mediave. Për shembull, në vitin 2024, një padi e ngritur nga Trim Ademi kundër gazetarit Robert Bojaj u diskutua gjerësisht nga organizatat e mediave dhe grupet e shoqërisë civile si Padi e mundshme Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP), që synonte dekurajimin e raportimit hulumtues. Përveç kësaj, gjatë vitit 2025, pati një rast në të cilin një kandidat për kryetar komune të Mitrovicës së Jugut kërcënoi mediat me veprime ligjore, duke u thirrur në dispozitat e Kodit Penal, pavarësisht se shpifja rregullohet si një çështje civile në Kosovë. Zakonisht, gazetarët i bëjnë publike paditë për shpifje sapo fillojnë procedurat gjyqësore; megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumë gjyqtarë në Kosovë kanë marrë trajnim mbi standardet e lirisë së mediave, gjë që është zhvillim pozitiv.

Të dhënat më të fundit për vitin 2025 tregojnë një rritje të dukshme të numrit të rasteve, me një total prej 236 padish të regjistruara për shpifje. Struktura e këtyre rasteve zbulon trende të rëndësishme. Shumica përfshijnë pretendime të kombinuara për shpifje dhe fyerje (afërsisht 95 raste), të ndjekura nga raste të veçanta shpifjeje (rreth 75 raste). Një numër i konsiderueshëm përfshijnë gjithashtu pretendime për kompensim financiar, ose të kombinuara me shpifje (rreth 30 raste) ose me shpifje dhe fyerje (afërsisht 45 raste). Një nëngrup më i vogël rastesh përfshin kërkesa për masa të përkohshme ose sigurie (rreth 10 raste), ndërsa rastet e bazuara vetëm në fyerje mbeten të rralla (afërsisht 4 raste).

Kjo shpërndarje sugjeron një tendencë në rritje për t'i kombinuar paditë ligjore – veçanërisht shpifjen, fyerjen dhe kompensimin financiar – duke rezultuar në rritjen e presionit mbi gazetarët. Në të njëjtën kohë, mungesa e të dhënave të detajuara mbi identitetin e paditësve vazhdon të kufizojë një vlerësim gjithëpërfshirës nëse padi të tilla po përdoren strategjikisht për të ndikuar ose penguar raportimin e mediave.

Gazetarët në përgjithësi deklarojnë se vetë dispozitat ligjore nuk e pengojnë drejtpërdrejt raportimin hulumtues ose kritik.⁴⁷ Megjithatë, numri në rritje i padive për shpifje, veçanërisht ato të paraqitura nga individë të pasur ose me ndikim, ka ngritur shqetësime në lidhje me një efekt të mundshëm dekurajues. Edhe kur gazetarët në fund fitojnë në gjykatë, koha, kostot ligjore dhe pasiguria që lidhen me procedura të tilla mund t'i dekurajojnë mediat më të vogla ose gazetarët e pavarur nga ndjekja e storjeve hulumtuese të ndjeshme.⁴⁸

47 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

48 Intervistë me Yll Zekaj, avokat dhe përfaqësues ligjor i AGK-së, Intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 15.01.2026.

Prandaj, organizatat mediatike kanë theksuar nevojën për mbrojtje më solide kundër padive SLAPP dhe për transparencë të përmirësuar në raportimin e të dhënave mbi rastet e shpifjes.⁴⁹ Forcimi i mbrojtjes ligjore për gazetarët dhe siguri që gjykatat të zbatojnë vazhdimisht standardet e proporcionalitetit mbeten elemente të rëndësishëm për mbrojtjen e lirisë së shprehjes në Kosovë.

— **A.7 LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE UA MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTERËVE TË TJERË TË MEDIAS TË PUNOJNË LIRSHËM DHE NË MËNYRË TË SIGURT.**

Korniza ligjore e Kosovës aktualisht nuk përmban dispozita specifike të hartuara për t'i parandaluar Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). Edhe pse ekzistojnë mbrojtje të përgjithshme procedurale brenda sistemit ligjor, nuk ekziston legjislacion i dedikuar që synon identifikimin ose hedhjen poshtë të padive abuzive që synojnë të heshtin gazetarët ose akterët e shoqërisë civile. Ekspertët e ligjit të mediave kanë theksuar se reforma e vazhdueshme e Kodit të Procedurës Civile⁵⁰ mund të ofrojë një mundësi për të futur masa të tilla mbrojtëse. Një analizë bazë legjislative e kryer nga juristja për media Flutura Kusari theksoi se ndryshimet në rregullat procedurale mund të përfshijnë mekanizma për t'i identifikuar dhe rrëzuar paditë që synojnë kryesisht t'i frikësojnë gazetarët në vend që të adresojnë dëmtimin legjitim të reputacionit. Gjatë periudhës së raportimit, Kosova nuk prezantoi legjislacion të ri që adresonte posaçërisht paditë SLAPP.⁵¹ Si rezultat, gazetarët dhe organizatat mediatike mbeten të cenueshme ndaj veprimeve ligjore të iniciuara nga individë të fuqishëm që mund të imponojnë barrë financiare dhe psikologjike edhe kur pretendimet nuk kanë bazë të fortë ligjore.

Gjatë vitit 2025, në Kosovë nuk u identifikuan raste të njohura publikisht të zbatimit arbitrar ose diskriminues të ligjeve të tjera. Vlerësimi më i fundit i AGK-së për Kosovën pohon se nuk u raportuan raste që përfshinin zbatimin diskriminues ose arbitrar të ligjeve të tjera për të heshtur gazetarët përmes barrës së tepërt të mbrojtjes ligjore. Vërehet se, edhe pse kornizës ligjore ende i mungojnë mbrojtje të posaçme kundër padive abuzive, kjo formë specifike e presionit nuk u dokumentua në periudhën raportuese.

Edhe pse të dhëna zyrtare gjithëpërfshirëse mbi rastet e padive SLAPP në Kosovë nuk janë në dispozicion, profesionistët e mediave raportojnë se padi të tilla mund të krijojnë presion mbi gazetarët duke i detyruar që t'i kushtojnë kohë dhe burime financiare mbrojtjes ligjore. Diskutimet në grupe fokusi me gazetarët tregojnë se disa profesionistë të mediave hezitojnë t'i diskutojnë publikisht paditë në vazhdim, veçanërisht kur ngrihen padi kundër tyre personalisht, për shkak të shqetësimeve në lidhje me dëmtimin e reputacionit ose procedurat e zgjatura

49 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

50 [Drafti i parë i Kodit të Procedurës Civile është përfunduar.](#)

51 Intervistë me Flutura Kusarin, juriste për media, intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 28.12.2025.

ligjore.⁵² Sipas AGK-së, ekziston një model i vazhdueshëm i padive të shumta për shpifje kundër gazetarëve, të cilat shpesh perceptohen si veprime të tipit SLAPP që synojnë frikësimin dhe rëndimin financiar të atyre që raportojnë për çështje me interes publik, veçanërisht korrupsionin dhe abuzimin me pushtetin.⁵³ Rastet që përfshijnë gazetarë dhe aktivistë si Ardiana Thaçi-Mehmeti, Robert Bojaj, Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Leonida Molliqaj janë dokumentuar në bazën e të dhënave të AGK-së. AGK vëren gjithashtu se shumë padi të tilla ka të ngjarë të mos raportohen sa duhet⁵⁴, veçanërisht kur gazetarët paditen në cilësinë e tyre personale. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025⁵⁵ konfirmon më tej çështjen, duke theksuar të paktën një rast SLAPP dhe nevojën që Kosova të harmonizojë kornizën e saj ligjore me standardet e BE-së kundër SLAPP. Forcimi i mbrojtjeve procedurale kundër padive abuzive dhe sigurimi i mbrojtjes efektive ligjore për gazetarët do të kontribonte në përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm për raportimin hulumtues dhe gazetarinë me interes publik.

— A.8 KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE ËSHTË I GARANTUAR NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Konfidencialiteti i burimeve gazetareske mbrohet qartë sipas kornizës ligjore të Kosovës. Ligji nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë⁵⁶ ofron garanci të forta për gazetarët dhe profesionistët e mediave që të mbajnë identitetin e burimeve të tyre konfidencial. Neni 4 i ligjit u jep gazetarëve të drejtën të refuzojnë të zbulojnë çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e një burimi, duke përfshirë dokumente, materiale ose të dhëna.⁵⁷

Ligji përcakton më tej se zbulimi i burimeve mund të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër gjykatë. Një zbulim i tillë lejohet vetëm kur është absolutisht i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz për jetën ose integritetin fizik dhe kur informacioni nuk mund të merret përmes formave të tjera. Këto masa mbrojtëse pasqyrojnë standardet e përcaktuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Këshilli i Evropës, duke njohur mbrojtjen e burimeve si një komponent themelor të lirisë së shprehjes.⁵⁸

Në praktikë, këto garanci ligjore duket se respektohen përgjithësisht nga autoritetet publike. Gjatë periudhës së raportimit, nuk pati raste të dokumentuara publikisht në të cilat gazetarët u detyruan nga autoritetet ose gjykatat që t'i zbulonin burimet e tyre.

Gjatë periudhës së raportimit nuk u raportuan raste në të cilat gazetarëve iu kërkua nga gjykatat ose autoritetet publike

52 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025

53 Intervistë me Xhemajl Rexhën, Kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, intervistuar nga Gëtoarbë Mulliqi, 28.12.2025.

54 Po aty

55 [Raporti i vitit 2025 për Kosovën*](#), Nëntor 2025.

56 [LIGJI NR. 04/L-137 PËR MBROJTJEN E BURIMEVE TË GAZETARISË.](#)

57 Intervistë me Mexhide Demolli Nimanin, Drejtoreshë Ekzekutive e Levizjes FOL, Intervistoi Gëtoarbë Mulliqi, 14.01.2026.

58 [Manual për praktikuesit ligjorë: Mbrojtja e të drejtës së lirisë së shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, MBROJTJA E TË DREJTËS SË LIRISË SË SHPREHJES SIPAS KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT](#), Dominika Bychawska-Siniarska.

që t'i zbulonin burimet e tyre. Ngjashëm, nuk pati raste të regjistruara të sanksioneve të vendosura ndaj gazetarëve për refuzimin e zbulimit të identitetit të një burimi.

Organizatave për monitorim të mediave kanë vazhduar ta theksojnë rëndësinë e ruajtjes së këtyre mbrojtjeve, duke vënë në dukje se mungesa e rasteve të tilla tregon një respekt relativisht të qëndrueshëm për mbrojtjet ligjore në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, vigjilenca e vazhdueshme konsiderohet e nevojshme⁵⁹ për të siguruar që këto standarde të respektohen në të ardhmen, veçanërisht në hetimet me ndjeshmëri.

Sipas profesionistëve të mediave dhe organizatave monitoruese, gazetarët investigativë në Kosovë në përgjithësi ndihen të aftë të kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte konfidenciale me burimet, duke përfshirë rastet që lidhen me korrupsionin, krimin e organizuar dhe llogaridhënien publike.⁶⁰ Korniza ligjore që mbron konfidencialitetin e burimit shihet si një faktor kyç që mundëson një punë të tillë dhe ruan besimin midis gazetarëve dhe sinjalizuesve⁶¹.

Ndërkohë që gazetarët ndonjëherë shprehin shqetësime më të gjera në lidhje me presionet, kërcënimet ose proceset e gjata gjyqësore kur raportojnë për çështje të ndjeshme, këto shqetësime nuk lidhen posaçërisht me dispozitat ligjore që rregullojnë mbrojtjen e burimeve.⁶² Në përgjithësi, korniza ekzistuese ligjore konsiderohet mbështetëse e gazetarisë hulumtuese dhe nuk krijon pengesa të rëndësishme për ruajtjen e burimeve konfidenciale.

— A.9 GAZETARËT JANË TË LIRË TA USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË KRIJOJNË, T'U BASHKOHEN DHE TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Gazetarët në Kosovë nuk e kanë të domosdoshme që të marrin një licencë shtetërore për të ushtruar profesionin e tyre. Korniza ligjore që rregullon median dhe lirinë e shprehjes nuk përcakton kërkesa për licencim, gjë që konsiderohet një mbrojtje e rëndësishme për lirinë dhe pavarësinë e mediave. Gjatë vitit 2025, nuk pati nisma legjislative ose propozime publike që synonin futjen e skemave të detyrueshme të licencimit për gazetarët. Prandaj, profesionistët e medias janë në gjendje të veprojnë lirisht pa autorizim formal nga institucionet shtetërore.

Në praktikë, gazetarët njihen përgjithësisht si profesionistë të mediave nga autoritetet publike kur kryejnë detyrat e tyre.⁶³ Ndërkohë që nga gazetarët shpesh pritet të mbajnë me vete një dokument identifikimi të lëshuar nga mediat përkatëse, veçanërisht kur mbulojnë protesta, zgjedhje ose ngjarje të mëdha publike, kjo kërkesë është më tepër praktike sesa ligjore. Gjatë periudhës së raportimit, nuk u regjistruan raste

59 Intervistë me Mexhide Demolli Nimanin, Drejtoreshë Ekzekutive e Levizjes FOL, Intervistoi Getoarë Mulliqi, 14.01.2026.

60 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

61 Intervistë me Mexhide Demolli Nimanin, Drejtoreshë Ekzekutive e Levizjes FOL, Intervistoi Getoarë Mulliqi, 14.01.2026.

62 Intervistë me Yll Zekaj, avokat dhe përfaqësues ligjor i AGK-së, Intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 15.01.2026.

63 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

sistematike në të cilat gazetarëve iu mohua qasja në ngjarje ose hapësira publike vetëm për shkak të mungesës së akreditimit.

Gazetarët në Kosovë janë të lirë të themelojnë dhe të anëtarësohen në shoqata profesionale. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës mbetet organi kryesor profesional që përfaqëson gazetarët dhe që mbron lirinë dhe sigurinë e mediave. Gjatë vitit 2025, nuk pati raste të raportuara të presionit ose ndërhyrjes nga autoritetet publike, pronarët e mediave ose akterë të tjerë që përpiqeshin t'i detyronin gazetarët të anëtarësoheshin në shoqata specifike. Në mënyrë të ngjashme, nuk u identifikuan prova të organizatave mediatike paralele ose "të rreme" që synonin minimin e rolit të shoqatave të gazetarisë. Iniciativat profesionale, përfshirë Rrjetin e Grave Gazetare të Kosovës, vazhdojnë të forcojnë përfaqësimin dhe mbështetjen brenda sektorit.

— A.10 E DREJTA PËR QASJE NË DOKUMENTE DHE INFORMACIONE ZYRTARE

E drejta për qasje në dokumente zyrtare në Kosovë rregullohet me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.⁶⁴, i cili u garanton gazetarëve dhe publikut të drejtën për të marrë informacione nga institucionet publike. Gazetarët shpesh mbështeten në kërkesat për qasje në informacione, veçanërisht në raportimin hulumtues mbi prokurimin publik, shpenzimet qeveritare dhe administratën publike. Megjithatë, zbatimi mbetet i pabarabartë. Vonesat në përgjigje dhe informatat e mangëta janë të zakonshme, shpesh për shkak të kapacitetit të kufizuar administrativ brenda institucioneve.

Monitorimi i shoqërisë civile ka vënë re gjithashtu se institucionet ndonjëherë dështojnë të ofrojnë justifikim të mjaftueshëm ligjor kur refuzojnë qasjen, duke zvogëluar efektivitetin e ligjit në praktikë. Kjo ilustruhet më tej nga rastet praktike të raportuara në mediat lokale. Për shembull, një hetim nga KALLXO.com tregoi se gazetarja Arbrita Uka duhej të priste rreth tre muaj dhe të paraqiste kërkesa të shumta zyrtare, duke përfshirë ankesa në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, për të marrë informacione bazë nga Ministria e Arsimit në lidhje me mosfunksionimin e një platforme për njohje diplomash. Rasti tregon se edhe informacioni jo i ndjeshëm mund të jetë subjekt i vonesave procedurale dhe barrierave administrative, duke kufizuar qasjen me kohë në informacionin publik.⁶⁵

Gazetarët kanë ngritur shqetësime në lidhje me praktikën jokonsistente dhe selektive të komunikimit nga institucionet publike.⁶⁶ Organet qeveritare shpesh mbështeten në kanale të kontrolluara komunikimi, siç janë deklaratat zyrtare dhe mediat sociale, duke kufizuar angazhimin e drejtpërdrejtë me gazetarët. Disa profesionistë të medias perceptojnë se qasja në informacione ose mundësitë e komunikimit mund të jenë të pabarabarta, megjithëse provat sistematike të diskriminimit formal mbeten të kufizuara.

64 [LIGJI NR. 06/L-081 PËR QASJEN NË DOKUMENTE PUBLIKE](#)

65 [QASJA E KUFIZUAR PENGON TRANSPARENCËN.](#)

66 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

Procedurat gjyqësore në Kosovë janë në përgjithësi të hapura për publikun dhe gazetarët zakonisht janë në gjendje të marrin pjesë dhe të raportojnë mbi seancat dëgjimore. Kufizime mund të aplikohen në raste specifike për të mbrojtur individët e cënueshëm ose informacionin e ndjeshëm, siç janë rastet që përfshijnë të mitur ose viktimë të trafikimit. Këto kufizime janë në përputhje me standardet ndërkombëtare që balancojnë transparencën dhe privatësinë.

Qasja në procedurat parlamentare në përgjithësi është e garantuar. Kuvendi i Kosovës u lejon gazetarëve të akredituar të marrin pjesë në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve, të cilat transmetohen edhe në internet. Gjersa gazetarët herë pas here kanë raportuar kufizime praktike, siç është hapësira e kufizuar brenda ambienteve parlamentare, nuk janë identifikuar kufizime formale që pengojnë mbulimin mediatik të punës parlamentare.

Në përgjithësi, korniza ligjore e Kosovës për qasjen në informacione është e fortë, por nevojitet një zbatim më i qëndrueshëm, kapacitet institucional i përmirësuar dhe praktika më të hapura komunikimi për të siguruar plotësisht transparencën dhe qasjen e barabartë për të gjitha mediat.

B. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

— B.1 POZITAT E PUNËS SË GAZETARËVE JANË TË QËNDRUESHME DHE TË MBROJTURA NË VENDIN E PUNËS

Në Kosovë, korniza ligjore garanton zyrtarisht të drejtat e punës për gazetarët përmes Ligjit të Punës⁶⁷, e cila kërkon kontrata pune me shkrim dhe ofron mbrojtje në lidhje me orarin e punës, pagat, kontributet shoqërore dhe sigurinë në vendin e punës. Megjithatë, në praktikë, stabiliteti i punësimit të gazetarëve mbetet i pabarabartë në të gjithë sektorin e mediave. Gjersa gazetarët që punojnë në media më të mëdha ose institucione publike kanë më shumë gjasa të kenë kontrata formale pune, gazetarët e punësuar nga media më të vogla private ose portale online shpesh raportojnë kontrata afatshkurtra, marrëveshje të pavarura ose kushte të parregullta kontraktuale, të cilat mund ta dobësojnë sigurinë në punë dhe qasjen në mbrojtjet ligjore.⁶⁸

Kushtet e punës në sektorin e mediave vazhdojnë të jenë sfiduese. Gazetarët shpesh raportojnë orë të gjata pune, ngarkesë të lartë pune dhe pasiguri në punë, veçanërisht në mediat private më të vogla me burime të kufizuara financiare. Një shqetësim tjetër lidhet me nivelet e pagave, të cilat mbeten relativisht të ulëta krahasuar me profesione të tjera që kërkojnë nivele të ngjashme arsimimi. Pagat mesatare për gazetarët në Kosovë vlerësohen përgjithësisht të variojnë midis 400 dhe 700 euro në muaj⁶⁹, varësisht nga media dhe përvoja e gazetarit. Edhe pse pagat në organizata më të mëdha mediatike kanë tendencë të jepen rregullisht, gazetarët që punojnë për media më të vogla kanë raportuar vonesa në paga ose praktika të parregullta pagese, si dhe kontribute të papaguara të sigurimeve shoqërore.⁷⁰

Nuk ekziston sindikatë gjithëpërfshirëse që përfaqëson gazetarët në tërë sektorin e mediave private në Kosovë. Sindikatat e vetme ekzistuese veprojnë brenda transmetuesit publik, RTK. Në mediat private, gazetarët mbeten kryesisht pa përfaqësim formal sindikal, dhe nuk dihet nëse ndonjë medie private i ka mbështetur gazetarët në themelimin e një sindikate ose në negociata kolektive. Si rezultat, nuk ekzistojnë marrëveshje kolektive në tërë sektorin për t'i mbrojtur të drejtat e punës së gazetarëve që punojnë në mediat private. Kushtet e tyre të punësimit zakonisht rregullohen përmes kontratave individuale, gjë që kufizon mbrojtjen kolektive të të drejtave të punës. Në praktikë, AGK shpesh luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e gazetarëve në sektorin privat, kryesisht përmes ndihmës ligjore dhe avokimit në kontestet që lidhen me punën.⁷¹

67 [LIGJI NR. 03/L –212 PËR PUNËN.](#)

68 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

69 Dokument dhe anketë e vlerësimit të nevojave të brendshme me 92 gazetarë gra.

70 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

71 [Yll Zekaj vazhdon mbështetjen ligjore për AGK-në dhe komunitetin e gazetarëve.](#)

— B.2 PAVARËSIA EDITORIALE NË MEDIAT PRIVATE

Pavarësia editoriale në mediat private të Kosovës njihet zyrtarisht, por mbetet e zbatueshme pabarabartë në praktikë. Disa media më të mëdha kanë miratuar struktura të brendshme organizative që synojnë të ndajnë vendimmarrjen editoriale nga departamentet e menaxhimit dhe ato komerciale. Këto rregullime zakonisht parashikojnë që politikat editoriale përcaktohen nga redaktorët dhe udhëheqja e redaksisë dhe jo nga menaxhmenti i biznesit. Krahësuar me vitet e kaluara, ndërgjegjësimi për rëndësinë e pavarësisë editoriale është rritur, veçanërisht për shkak të debatit të vazhdueshëm publik mbi lirinë e mediave dhe standardet profesionale.⁷² Megjithatë, në praktikë këto rregulla të brendshme nuk respektohen gjithmonë në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht në mediat më të vogla ku presionet financiare dhe pronarët mund të ndikojnë drejtpërdrejt në vendimet editoriale.⁷³

Lidhur me standardet profesionale, shumica e mediave private në Kosovë nuk i mbajnë kodet e tyre të brendshme të etikës, por mbështeten në Kodin e Etikës për Mediat e Shkruara dhe ato Online⁷⁴, i miratuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe i njohur gjerësisht në tërë sektorin e mediave. Për mediat audiovizuale, sjellja profesionale rregullohet përmes Kodit të Sjelljes për Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizuale, të miratuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), i cili përcakton standardet për përgjegjësinë editoriale, mbrojtjen e të miturve dhe raportimin e balancuar.⁷⁵ Në të njëjtën kohë, mediat që marrin grante ose fonde për projekte nga organizatat ndërkombëtare shpesh miratojnë rregullore dhe politika shtesë të brendshme në mënyrë që t'i përmbushin kërkesat e donatorëve. Këto zakonisht përfshijnë politika të barazisë gjinore, politika për parandalimin e ngacmimit seksual, rregulla kundër diskriminimit dhe standarde të integritetit në vendin e punës, si dhe procedura që lidhen me transparencën editoriale dhe raportimin etik.⁷⁶ Përveç kësaj, organizatat profesionale si AGK, shpesh në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe organizata të zhvillimit të medias, punojnë për të promovuar ndërgjegjësimin dhe zbatimin e standardeve ekzistuese etike.⁷⁷ Përmes programeve të trajnimit, udhëzimeve dhe iniciativave të avokimit, këto organizata synojnë ta forcojnë respektimin e kodeve të etikës dhe standardeve profesionale të përcaktuara në tërë sektorin e mediave.

Pavarësisht ekzistencës së këtyre standardeve profesionale, gazetarët vazhdojnë të raportojnë forma të ndryshme të presionit që ndikojnë në pavarësinë editoriale. Format më të zakonshme përfshijnë ndërhyrjen editoriale nga pronarët e mediave ose menaxherët e lartë, presionin për ta përshtatur mbulimin në përputhje me interesat politike ose të biznesit dhe ndikimin nga reklamuesit ose akterët e jashtëm. Në

72 [Lansimi i Udhëzuesit për Politika Editoriale.](#)

73 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

74 [KODI I ETIKËS I KMSH-K-së.](#)

75 [KKPM-2016-03 KODI I ETIKËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS](#) <https://kpm-ks.org/cmsapi/content/media/5233D8DD-5822-4265-4CBBFD>.

76 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

77 [Udhëzues për Politikat Editoriale.](#)

disa raste, gazetarët raportojnë presion për të shmangur tema të caktuara, për të zbutur raportimin kritik ose për t'i dhënë përparësi përmbajtjes që i shërben interesave komerciale ose politike.⁷⁸ Cenueshmëria ekonomike e shumë mediave rrit më tej rrezikun e presioneve të tilla, veçanërisht në redaksitë më të vogla që mbështeten shumë në të ardhurat nga reklamat ose patronazhin politik.

— B.3 PAVARËSIA EDITORIALE NË MEDIAT E SHËRBIMIT PUBLIK

Parimet etike dhe standardet profesionale të gazetarisë brenda Medias së Shërbimit Publik të Kosovës, RTK-së, rregullohet nga rregullorja e brendshme. Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës përcakton se politika editoriale e RTK-së duhet të jetë e pavarur, e drejtë, profesionale, objektive, e balancuar dhe e paanshme.⁷⁹ Për më tepër, ajo vepron sipas "Standardeve Profesionale dhe Parimeve Etike të Gazetarisë në RTK"⁸⁰, ndërsa gazetarët e saj janë gjithashtu të obliguar të veprojnë në përputhje me kornizat më të gjera profesionale të Kosovës për median audiovizuale. Formalisht, korniza ekziston dhe gazetarët në përgjithësi përpiqen të punojnë brenda saj. Në praktikë, megjithatë, problemet e pajtueshmërisë në vitin 2025 erdhën më pak nga gazetarët e thjeshtë dhe më shumë nga ndërhyrja e menaxhmentit, duke përfshirë veprimet ndëshkuese kundër redaktorëve të RTK-së.⁸¹

Ligji për RTK-në kërkon që transmetuesi t'i shërbejë interesit publik dhe parashikon struktura qeverisëse që synojnë ta mbrojnë pavarësinë editoriale. Në praktikë, këto masa mbrojtëse nuk u respektuan në mënyrë të vazhdueshme në vitin 2025. Ky vit nxori në pah dobësinë e këtyre mbrojtjeve të brendshme, veçanërisht kur menaxhmenti ndërmori veprime kundër redaktorëve dhe kur transmetuesi operoi në mes të paqëndrueshmërisë së qeverisjes dhe financimit.⁸²

Presioni më i zakonshëm është presioni indirekt politik dhe financiar, veçanërisht përmes kontrollit të buxhetit, vonesave në financim, paqëndrueshmërisë së qeverisjes dhe ndikimit mbi strukturat e menaxhimit. Në vitin 2025, kjo u përkeqësua nga vonesat e pagave, një situatë e dobët në bord dhe përpjekje më të gjera për të formësuar klimën e brendshme në RTK. Prandaj, presioni u ushtrua më pak përmes censurës së hapur dhe më shumë përmes levave financiare dhe vendimeve menaxheriale të ndikuara politikisht.⁸³⁸⁴

Shembulli më i qartë ishte kriza e financimit dhe pagave të RTK-së në gusht⁸⁵ dhe nëntor⁸⁶ të vitit 2025. Punonjësit e RTK-së mbetën dy herë pa paga, gjë që e shndërroi financimin në një pikë presioni të drejtpërdrejtë që prekte të gjithë

78 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

79 Republika e Kosovës. [Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës](#).

80 [Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë](#).

81 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

82 Po aty.

83 [Kosovë: FEG i bashkohet thirrjes urgjente për ndarje të mjaftueshme të buxhetit për transmetuesin publik RTK](#).

84 [AGK e zhgënjyer nga dështimi i qeverisë për të ndarë buxhetin e RTK-së nga kursimet](#).

85 [Punonjësit e RTK-së dy javë pa paga — Qeverisë i kërkohet të ndajë buxhetin](#).

86 [Kosovë: FEG i bashkohet thirrjes urgjente për ndarje të mjaftueshme të buxhetit për transmetuesin publik RTK](#).

transmetuesin. Në të njëjtën kohë, AGK dënoi publikisht masat ndëshkuese kundër redaktorëve të RTK-së në mars 2025, si dhe largimin arbitrar të 6 gazetarëve nga televizioni.⁸⁷⁸⁸ Së bashku, këto zhvillime treguan se si varësia financiare dhe vendimet e menaxhimit të ndikuara politikisht mund të dëmtojnë pavarësinë editoriale në të gjithë transmetuesin publik.

— B.4 PAVARËSIA EDITORIALE NË SEKTORIN E MEDIAVE JOFITIMPRURËSE

Spektori i mediave jofitimprurëse në Kosovë është zgjeruar, megjithëse mbetet dukshëm më i vogël se tregu i mediave private. Gjersa ende nuk ka regjistrë zyrtar që rendit specifikisht mediat jofitimprurëse, disa organizata të themeluara veprojnë brenda këtij modeli. Ndër më të shquarat janë K2.0, BIRN dhe Kallxo, Betimi për Drejtësi dhe Prishtina Insight, të cilat përqendrohen kryesisht në gazetarinë hulumtuese dhe raportimin e thelluar. Platforma të tjera si Sbunker prodhojnë kryesisht përmbajtje analitike dhe të bazuar në opinione. Përveç kësaj, media si KoSSev, Romano Avazo dhe Radio Gorazdevac ofrojnë shërbime mediatike për komunitetet jo-shumicë, duke kontribuar në pluralizmin dhe përfaqësimin më të gjerë të mediave në Kosovë. Në përgjithësi, prania në rritje e iniciativave mediatike të bazuara në OJQ pasqyron sfidat strukturore me të cilat përballen mediat private, veçanërisht qëndrueshmërinë financiare. Krahasuar me mediat komerciale, organizatat jofitimprurëse në përgjithësi kanë qasje më të madhe në grantet e donatorëve dhe financimin institucional, gjë që ka inkurajuar zhvillimin gradual të këtij sektori pavarësisht shkallës së tij ende më të vogël në krahasim me tregun e mediave private.

Krahasuar me pjesën më të madhe të sektorit privat të mediave, organizatat kryesore jofitimprurëse të mediave në Kosovë në përgjithësi veprojnë sipas kodeve të brendshme të sjelljes dhe statuteve organizative të hartuara për të mbrojtur pavarësinë editoriale dhe për të mbështetur standardet profesionale. Perceptohet gjerësisht se organizatat jofitimprurëse të mediave demonstrojnë një nivel më të lartë të pajtueshmërisë me këto standarde të brendshme, kryesisht për shkak të kërkesave të donatorëve dhe mbikëqyrjes së fortë institucionale. Si rezultat, gazetarët që punojnë në sektorin jofitimprurës shpesh janë më të informuar rreth politikave editoriale, standardeve etike dhe mbrojtjeve profesionale sesa homologët e tyre në sektorë të tjerë të medias.⁸⁹ Një nivel i ngjashëm ndërgjegjësimi vërehet edhe midis gazetarëve të pavarur, të cilët shpesh bashkëpunojnë me organizata mediatike jofitimprurëse dhe projekte ndërkombëtare që kërkojnë respektim të kornizave të rrepta editoriale dhe etike.⁹⁰

Në vitin 2025, zvogëlimi dhe tërheqja e disa rrjedhave të financimit ndërkombëtar u bë veçanërisht problematike si për mediat jofitimprurëse ashtu edhe për organizatat e shoqërisë civile në përgjithësi. Kjo mungesë e financimit të

87 [AGK dënon fuqishëm largimin arbitrar të gjashtë gazetarëve të RTK-së nga televizioni.](#)

88 [Deklarata e Menaxhmentit të RTK-së përbën kërcënim publik ndaj gjashtë redaktorëve.](#)

89 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

90 Po aty.

qëndrueshëm është bërë një nga sfidat kryesore për sektorin. Pavarësisht vështirësive të tyre të vazhdueshme, të cilat përfshijnë padi, fushata shpifjesh dhe sulme politike, mediat jofitimprurëse vazhdojnë të mbeten një nga shtyllat kryesore të gazetarisë së pavarur dhe hulumtuese në Kosovë.⁹¹

— B.5 LIRIA E GAZETARËVE NË PROCESIN E PRODHIMIT TË LAJMEVE

Gazetarët në Kosovë në përgjithësi theksojnë se kanë liri formale për të propozuar dhe zgjedhur storje, veçanërisht në redaksitë më të mëdha dhe mediat e pavarura. Megjithatë, niveli i lirisë në formësimin e narrativave dhe theksimin e aspekteve specifike të një storjeje mbetet disi i kufizuar në praktikë. Gazetarët kanë tendencë të jenë më shumë në shënjestër, veçanërisht kur raportojnë për çështje politikisht të ndjeshme ose tema që lidhen me akterë të fuqishëm ekonomikë.⁹² Gjersa kufizimet e qarta editoriale vendosen rrallë, përparësitë e redaksisë shpesh ndikohen nga politikat editoriale më të gjera, pritjet e audiencës dhe strukturat e pronësisë.

Gazetarët në përgjithësi pranojnë se interesat financiare dhe komerciale të pronarëve të mediave synojnë të ndikojnë në prioritetet e redaksisë, edhe nëse një ndikim i tillë rrallë shprehet përmes udhëzimeve të drejtpërdrejta. Këto ndikime janë shpesh të tërthorta, duke formësuar vendimet se cilat tema marrin më shumë vëmendje ose cilat histori ndiqen me më shumë kujdes. Pavarësisht kësaj, gazetarët raportojnë se përpiqen të ruajnë integritetin profesional dhe të përballojnë këto presione, ndërkohë që vazhdojnë të raportojnë për çështje me interes publik.⁹³ Disa gazetarë gjithashtu deklarojnë se, kur përballen me konflikte serioze etike, ata preferojnë t'i ndryshojnë vendet e punës në vend që të bëjnë kompromis me standardet profesionale, gjë që pasqyron një angazhim të vazhdueshëm për raportim të pavarur pavarësisht kufizimeve strukturore.⁹⁴

Censura e drejtpërdrejtë editoriale rrallë raportohet hapur, por vetëcensura mbetet një shqetësim brenda mjedisit mediatik të Kosovës. Disa gazetarë pranojnë se herë pas here shmangin tema të caktuara, ndërsa frika e humbjes së punësimit, e kombinuar me një treg konkurrues mediatik dhe stabilitet relativisht të ulët të punës, kontribon në një klimë ku gazetarët mund të preferojnë të veprojnë me kujdes sesa të rrezikojnë pasoja profesionale.⁹⁵ Si rezultat, edhe pa presion të qartë nga redaktorët, mjedisi më i gjerë mediatik mund të çojë në vetëcensurë indirekte dhe raportim më të përmbajtur.

— B.6 POZITA E PUNËS SË GRAVE GAZETARE

Gratë gazetare në Kosovë në përgjithësi veprojnë në kushte të ngjashme formale punësimi si kolegët e tyre meshkuj, veçanërisht në mediat më të mëdha ku marrëveshjet

91 Intervistë me Xhemajl Rexhën, Kryetar i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi, 28.12.2025.

92 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

93 Po aty.

94 Dokument dhe anketë e vlerësimit të nevojave të brendshme me 92 gazetarë gra

95 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

kontraktuale dhe strukturat e redaksisë zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë punonjësit. Megjithatë, gratë kanë tendencë të mbajnë më shumë pozita të nivelit të ulët dhe të mesëm, ndërsa kolegët e tyre meshkuj përfaqësohen më shpesh në role të nivelit të mesëm dhe të lartë, veçanërisht në pozita udhëheqëse editoriale dhe menaxheriale.⁹⁶ Gjetjet e reja nga Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës tregojnë se ekziston një hendek gjinor në paga brenda sektorit të mediave.⁹⁷ Edhe pse pagat në shumicën e mediave lidhen zyrtarisht me faktorë të tillë si pozita, përvoja dhe koha në punë, këto gjetje sugjerojnë që gjinia ndikon edhe në mënyrë indirekte në nivelet e pagave, kryesisht sepse burrat zënë më shpesh pozita me grada më të larta dhe më të paguara brenda organizatave mediatike. Në të njëjtën kohë, kur bëhet fjalë për detyrat editoriale dhe temat e raportimit, gratë gazetare në përgjithësi nuk përjashtohen nga mbulimi i ndonjë fushe specifike të raportimit, duke përfshirë politikën dhe hetimet.

Gratë gazetare janë gjithnjë e më të dukshme në peizazhin mediatik të Kosovës dhe zënë një numër të konsiderueshëm rolesh brenda redaksive (65%). Megjithatë, burrat ende dominojnë në shumë pozita të larta editoriale dhe menaxheriale, veçanërisht në nivelin e kryeredaktorëve, pronarëve të mediave dhe menaxhmentit të lartë të redaksive.⁹⁸ Edhe pse ka pasur përparim gradual viteve të fundit, gratë mbeten të nën-përfaqësuara në pozita vendimmarrëse krahasuar me praninë e tyre të përgjithshme në profesionin e gazetarisë.⁹⁹ Iniciativat nga organizatat profesionale, përfshirë Rrjetin e Grave Gazetare të Kosovës, kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit rreth barazisë gjinore dhe në inkurajimin e një pjesëmarrjeje më të madhe të grave në role udhëheqëse brenda institucioneve mediatike.

Gratë gazetare në Kosovë raportojnë se përjetojnë presione dhe ngacmime specifike me bazë gjinore, veçanërisht në hapësirat online. Gratë gazetare (si dhe aktivistet) janë më shpesh në shënjestër të fyerjeve gjinore, komenteve mizogjine dhe kërcënimeve në mediat sociale, shpesh të lidhura me dukshmërinë e tyre publike ose raportimin mbi çështje të ndjeshme.¹⁰⁰ Këto sulme mund të krijojnë një mjedis kërcënues dhe mund t'i dekurajojnë gratë nga pjesëmarrja e plotë në debatet publike. Përveç ngacmimit online, disa gazetare raportojnë se përballen me stereotipe, diskriminim ose qëndrime përcmuese brenda mjediseve profesionale.¹⁰¹ Pavarësisht këtyre sfidave, rrjetet dhe shoqatat profesionale vazhdojnë të avokojnë për mbrojtje më të fortë dhe njohje më të madhe të sfidave me të cilat përballen gazetaret në Kosovë.

96 [Pozita dhe siguria e grave gazetare në Kosovë.](#)

97 Intervistë me Gentiana Begolli Pustina, Anëtare e Panelit Këshillues të Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës, Intervistuar nga Getoarabë Mulliqi, 20.01.2026.

98 [Pozita dhe siguria e grave gazetare në Kosovë.](#)

99 Intervistë me Gentiana Begolli Pustina, Anëtare e Panelit Këshillues të Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës, Intervistuar nga Getoarabë Mulliqi, 20.01.2026.

100 [Jo i bjen JO, edhe online!](#)

101 Dy grupe fokusi me gazetarë dhe redaktorë nga mediat publike, private dhe OJQ-të në Kosovë, 12-13.12.2025.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

— C.1 GAZETARËT DHE AKTERËT E MEDIAVE KANË QASJE NË MASA MBROJTËSE TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE KUR KËRCËNOHEN

Kosova ende nuk ka krijuar një mekanizëm të dedikuar institucional, siç është një linjë telefonike ose një pikë kontakti për raste emergjente, posaçërisht për gazetarët, për të raportuar kërcënime, gjuhë urrejtjeje ose rreziqe serioze për sigurinë e tyre. Ashtu si në vitet e kaluara, gazetarët kryesisht raportojnë incidente të tilla përmes mekanizmave të përgjithshëm të raportimit të Policisë së Kosovës, duke përfshirë numrat e emergjencës dhe stacionet lokale të policisë. Në praktikë, gazetarët gjithashtu kontaktojnë shpesh Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës, e cila dokumenton incidentet, ofron mbështetje për gazetarët dhe i referon rastet tek institucionet përkatëse. Kjo situatë mbetet kryesisht e pandryshuar krahasuar me vitin 2024, kur mungesa e mekanizmave të specializuar të raportimit për gazetarët u theksua edhe në raportet e monitorimit mbi lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve.

Kërcënime dhe sulme ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve Sulmet aktuale mbi pronën e organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, pajisjet e sekuestruara, deklaratat agresive nga zyrtarët publikë etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e renditura më sipër.	17	– Gjatë protestave që përfshinin ndërmarrjen publike Trafiku Urban, mediat dhe gazetarët u penguan të raportonin dhe u përballën me pengesa në kryerjen e punës së tyre. – Kandidati për kryetar të Komunës së Mitrovicës, Faton Peci, ka sulmuar TV Dukagjinin duke e cilësuar si “qendër operative të një ndërmarrje kriminale”. – Një sulm kibernetik ka pasur në shënjestër median online Buletini Ekonomik. – Deputetja e VV-Guxo dhe Ministria në Detyrë e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, sulmoi gazetarët dhe mediat në dy postime në Facebook, duke i quajtur ata gjithçka tjetër pos gazetarë. – Kryeministri në detyrë Albin Kurti fajësoi mediat dhe gazetarët për rënien e Kosovës në vendin e 99-të në Indeksin e Reporterëve pa Kufij. – Deputeti i VV-së, Salih Zyba ka përdorur gjuhë nxitëse kundër Gazetës Express. – Zyrtarët e VV-së përdorën gjuhë shpifëse kundër Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK) dhe Kryetarit Xhemajl Rexha, duke nisur një fushatë publike shpifjesh për të diskredituar si organizatën ashtu edhe Kryetarin. – Kryeministri në detyrë Albin Kurti, gjatë një tubimi në Gjilan, sulmoi mediat, duke i quajtur ato “portale të disa oligarkëve”. – Televizioni Syri Vision në Gjakovë u shkatërrua pasi një individ drejtoi një automjet të rëndë në ambientet e tij. – Dy ditë para zgjedhjeve, Kryeministri në detyrë Albin Kurti sulmoi verbalisht mediat, duke deklaruar se “portalet janë pjesë e Trekëndëshit të Bermudës që dëshiron ta fundosë Kosovën”. – Sami Kurteshi, anëtar i VV-së në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, iu përgjigj një pyetjeje nga Besarta Hoti e Nacionale duke thënë: “Ju jeni media kriminale, vrasës me pagesë.” – Ambientet e medias online Veriu.info në Mitrovicë u demoluan. – Pjesëmarrësit dhe zyrtarët e VV-së në një tubim elektoral në Malishevë penguan ekipin Nacionale. – Ekipi i “Betimi për Drejtësi” ngriti një padi penale kundër tri faqeve online për sulme dhe ngacmime të vazhdueshme. – Arlind Manxhuka, zëdhënës i VV-së, shënjestroi mediat dhe i sulmoi ato duke i etiketuar si “institucione paralele”, duke nënkuptuar se ato vepronin ngjashëm me strukturat paralele serbe në Kosovë. – Me nisjen e fushatës për zgjedhjet parlamentare, VV njoftoi bojkotimin e Klan Kosova, T7 dhe TV Dukagjini, tre nga stacionet kryesore televizive në Kosovë.



Përfundime dhe rekomandime

PËRFUNDIMET

MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Korniza ligjore e Kosovës ofron garanci të forta formale për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Kushtetuta përfshin instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndërsa ligje specifike rregullojnë qasjen në dokumente publike, mbrojtjen e burimeve gazetareske dhe funksionimin e institucioneve të medias. Shpifja është dekriminalizuar dhe mjedisi ligjor, në parim, ofron mbrojtje të mjaftueshme për gazetarët. Megjithatë, zbatimi mbetet i paqëndrueshëm dhe shpesh joefektiv në praktikë. Vonesat e vazhdueshme në qasjen në informata publike, zbatimi i dobët i ligjeve ekzistuese dhe llogaridhënia e kufizuar institucionale vazhdojnë të dëmtojnë këto mbrojtje.

Shqetësimet janë gjithashtu të dukshme në lidhje me pavarësinë dhe funksionimin e organit kyç rregullator, Komisionit të Pavarur të Mediave, i cili është përballur me sfida qeverisjeje, presion politik dhe paralizë operationale për shkak të mungesës së kuorumit. Në mënyrë të ngjashme, mungesa e mbrojtjeve kundër padive abuzive, duke përfshirë SLAPP-et, i ekspozon gazetarët ndaj presioneve financiare dhe ligjore. Në përgjithësi, ndërsa Kosova ka krijuar një bazë të fortë ligjore, boshllëqet në zbatim, ndikimi politik dhe joefikasiteti institucional e kufizojnë ndjeshëm efektivitetin e saj. Forcimi i mekanizmave të zbatimit, sigurimi i pavarësisë së institucioneve dhe përputhja me standardet evropiane në zhvillim, veçanërisht në adresimin e SLAPP-eve, mbeten thelbësore për përmirësimin e mbrojtjes së gazetarëve.

POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

Pozita e gazetarëve në redaksitë e Kosovës mbetet e brishtë dhe shpesh karakterizohet nga shkeljet e të drejtave të punës dhe kushtet e këqija të punës. Shumë gazetarë punojnë me kontrata afatshkurtra ose joformale, përballen me vonesa në paga dhe nuk kanë qasje të plotë në mbrojtje sociale. Pavarësisht këtyre sfidave, gazetarët vazhdojnë t'i respektojnë standardet profesionale, megjithëse kjo kërkon përpjekje të vazhdueshme në një mjedis gjithnjë e më të vështirë. Gazetarët sfidohen rregullisht nga brenda redaksive, veçanërisht nga departamentet e menaxhimit dhe marketingut, ku interesat komerciale mund të ndikojnë në vendimet editoriale. Në të njëjtën kohë, ata përballen me presion të jashtëm nga akterët politikë, bizneset dhe palët e treta, gjë që e ndërlikon më tej punën e tyre dhe mund të kufizojë pavarësinë editoriale.

Mungesa e një sindikate gjithëpërfshirëse të gazetarëve e dobëson ndjeshëm pozitën e tyre. Pa mbrojtje dhe përfaqësim kolektiv, gazetarët lihen t'i përballojnë këto presione individualisht, duke i bërë ata më të prekshëm ndaj shfrytëzimit dhe ndërhyrjes.

Gazetarët në Kosovë veprojnë në një pozicion të ndjeshëm dhe kërkues, duke balancuar integritetin profesional me pasigurinë ekonomike dhe shtresat e shumëfishta të presionit. Forcimi i mbrojtjes së punës dhe krijimi i një sindikate funksionale dhe gjithëpërfshirëse mbeten thelbësore për përmirësimin si të kushteve të punës ashtu edhe të qëndrueshmërisë së gazetarisë.

SIGURIA E GAZETARËVE

Siguria e gazetarëve në Kosovë gjatë vitit 2025 u sfidua vazhdimisht, në një vit të shënuar nga katër procese zgjedhore dhe fushata të vazhdueshme politike. Konteksti i stërzgatur zgjedhor i intensifikoi edhe tensionet politike dhe kontriboi në një klimë armiqësore për media, veçanërisht në mungesë të përgjigjeve të forta dhe të qëndrueshme institucionale.

Sipas AGK-së, viti 2025 regjistroi një nga numrat më të lartë të sulmeve kundër gazetarëve që nga themelimi i saj, me 69 raste të dokumentuara. Ndërsa viti 2023 mbetet viti me më së shumti raste, gjithsej 74, është e rëndësishme të theksohet se rreth 30 nga këto incidente ndodhën brenda pak ditësh në veri të Kosovës. Në anën tjetër, rastet e regjistruara në vitin 2025 ishin të shpërndara në mënyrë më të barabartë dhe të vazhdueshme gjatë gjithë vitit, duke e bërë situatën veçanërisht shqetësuese.

Një tipar përcaktues i vitit 2025 ishte rritja e sulmeve verbale, gjuhës përçmuese dhe delegjitimizimit të gazetarëve nga akterët politikë dhe figurat publike me ndikim, përfshirë anëtarët e qeverisë. Kjo retorikë jo vetëm që minoi besimin në media, por gjithashtu kontriboi në një klimë që normalizon presionin dhe armiqësinë ndaj gazetarëve. Gazetarët vepruan në një mjedis me rrezik të lartë, ku diskursi politik, mungesa e llogaridhënies dhe mekanizmat e dobët të mbrojtjes institucionale vazhduan të

minonin sigurinë e tyre. Forcimi i përgjigjeve institucionale dhe garantimi i dënimit publik të sulmeve mbeten përparësi kritike.

PËRFUNDIM I PËRGJITHSHËM

Gjendja e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë gjatë vitit 2025 pasqyron një hendek të vazhdueshëm midis garancive të forta ligjore dhe zbatimit të dobët në praktikë. Gjersa korniza ligjore e vendit është gjerësisht në përputhje me standardet evropiane, sfidat sistematike, veçanërisht presioni politik, brishtësia institucionale dhe cenueshmëria ekonomike vazhdojnë të formësojnë mjedisin mediatik. Viti u shënua nga cikle të vazhdueshme zgjedhore dhe tensione të larta politike, të cilat ndikuan drejtpërdrejt në sigurinë dhe kushtet e punës së gazetarëve. Retorika armiqësore në rritje nga akterët politikë, e kombinuar me përgjigjet e dobëta institucionale, kontribuan në një mjedis ku presioni mbi gazetarët u normalizua edhe më shumë. Në të njëjtën kohë, krizat e qeverisjes brenda institucioneve kryesore, duke përfshirë organet rregullative dhe transmetuesin publik, minuan më tej besimin dhe llogaridhënien. Në aspektin ekonomik, sektori i mediave mbetet i brishtë dhe i paqëndrueshëm, pa mekanizma gjithëpërfshirës të mbështetjes publike dhe pa mbështetje të madhe në tregjet e kufizuara të reklamave dhe financimin e donatorëve. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e redaksisë, duke kontribuar në punësim të pasigurt, vetëcensurë dhe kapacitet të reduktuar për gazetari hulumtuese. Në përgjithësi, peizazhi mediatik i Kosovës mbetet pluralist, por i cenueshëm. Adresimi i këtyre sfidave kërkon forcimin e pavarësisë institucionale, përmirësimin e zbatimit të ligjeve ekzistuese, sigurimin e financimit të qëndrueshëm dhe forcimin e mekanizmave mbrojtës për gazetarët. Pa reforma të tilla, hendeku midis standardeve formale dhe realiteteve të përditshme ka të ngjarë të vazhdojë.

REKOMANDIMET

A. MASAT MBROJTËSE LIGJORE DHE ZBATIMI I TYRE

Çfarë duhet bërë:

- Të miratohet një Ligj i ri për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe Këshillit të Evropës, duke siguruar pavarësi në procedurat e emërimit dhe shkarkimit.
- Të garantohet qeverisje funksionale e RTK-së, duke përfshirë emërimin me kohë të anëtarëve të Bordit dhe një model financimi të qëndrueshëm dhe të pavarur.
- Të futen dispozita anti-SLAPP në përputhje me Direktivën e BE-së dhe të vendosen masa mbrojtëse kundër padive abuzive.
- Të forcohet zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke përfshirë sanksionet për vonesat dhe mosrespektimin e tij nga institucionet.

- Të vendosen rregulla të qarta ligjore për reklamat shtetërore dhe transparencën e financimit publik.
- Të përmirësohet koordinimi midis institucioneve (KGJK, KPK, Policia, AIP) dhe të sigurohet mbledhja sistematike e të dhënave mbi rastet që përfshijnë gazetarët.

Çfarë duhet të bëjnë organizatat e gazetarëve (sidomos AGK):

- Të vazhdohet me avokimin ligjor për reformën e KPM-së dhe legjislacionin anti-SLAPP.
- Të përmirësohet dhe të mirëmbahet një bazë e të dhënave gjithëpërfshirëse dhe të disagreguar të sulmeve dhe çështjeve ligjore.
- Të lehtësohet dialogu i rregullt me gjyqësorin dhe rregullatorët.
- Të ofrohen trajnime të synuara për gjyqtarët dhe prokurorët mbi standardet e lirisë së shprehjes.

B. POZITA E GAZETARËVE NË REDAKSITË E LAJMEVE

Çfarë duhet bërë:

- Të sigurohet zbatim i rreptë i legjislacionit të punës në sektorin e mediave, duke përfshirë kontratat, pagat dhe mbrojtjet sociale.
- Të mbështetet krijimi i një sindikate gazetarësh që është funksionale dhe gjithëpërfshirëse.
- Të futen standarde minimale për kontratat e punësimit dhe kushtet e punës në të gjitha mediat.
- Të zvogëlohet ndikimi i panevojshëm i strukturave të menaxhimit dhe marketingut në përmbajtjen editoriale.
- Të promovohen politikat e redaksisë së lajmeve të ndjeshme ndaj gjinisë dhe gjithëpërfshirëse.

Çfarë duhet të bëjnë shoqatat e gazetarëve:

- Të udhëhiqet avokimi për mbrojtjet e punës specifike për sektorin.
- Të lehtësohet krijimi i një sindikate gazetarësh përmes konsultimeve gjithëpërfshirëse.
- Të ofrohet ndihmë ligjore dhe trajnim mbi të drejtat e punës.
- Të zgjerohen programet e mbështetjes së shëndetit mendor për gazetarët.
- Të forcohet bashkëpunimi me mediat për të mbrojtur pavarësinë editoriale.

C. SIGURIA E GAZETARËVE

Çfarë duhet bërë:

- Të krijohet një mekanizëm funksional kombëtar për mbrojtjen e gazetarëve, duke përfshirë protokollet e reagimit të shpejtë.
- Të sigurohet dënimi i vazhdueshëm dhe publik i sulmeve nga institucionet shtetërore, veçanërisht gjatë periudhave zgjedhore.
- Të forcohet roli dhe kapaciteti i oficerëve të policisë dhe prokurorëve të caktuar që merren me çështjet e medias.
- Të krijohen përgjegje specifike ndaj presionit politik dhe retorikës armiqësore, duke përfshirë masa llogaridhënieje për zyrtarët publikë.
- Të përmirësohet mbledhja e të dhënave dhe transparenca mbi sulmet, kërcënimet dhe rastet SLAPP.

Çfarë duhet të bëjnë organizatat e gazetarëve (AGK):

- Të vazhdohet monitorimi dhe raportimi sistematik i sulmeve, veçanërisht gjatë zgjedhjeve.
- Të avokohet për llogaridhënie institucionale për presionin politik dhe sulmet verbale.
- Të sigurohet mbrojtje ligjore dhe mekanizma mbështetjeje emergjente për gazetarët në rrezik.
- Të bëhet forcimi i partneriteteve me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtarë mbi mekanizmat e sigurisë.
- Të promovohen fushata ndërgjegjësimi mbi sigurinë dhe rolin e gazetarëve në demokraci.

PRIORITETET STRATEGJIKE PËR AGK-NË

- Fokusi në katër shtylla:
 - Pavarësia institucionale dhe reforma ligjore
 - Të drejtat e punës dhe kushtet në redaksinë e lajmeve
 - Siguria e gazetarëve në mjedise të polarizuara politikisht
 - Përgjegjësia për presionin politik dhe diskursin publik
- Të udhëhiqet avokimi i koordinuar me institucionet shtetërore dhe partnerët ndërkombëtarë.
- Të bëhet forcimi i monitorimit, mbështetjes ligjore dhe kapaciteteve të reagimit të shpejtë.


IV

Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve në Kosovë – 2025

Ky seksion i raportit paraqet grafikisht Indeks të Sigurisë së Gazetarëve në vitin 2025, krahasuar me vitin e kaluar 2024. Për secilin nga katër dimensionet dhe për të 19 treguesit, është paraqitur një shpjegim i shkurtër i ndryshimeve kryesore që kanë ndodhur në vitin 2025.

Një shpjegim më i gjerë i të dhënave dhe ndryshimeve që kanë ndodhur për secilin tregues individual të Indeksit mund të lexohet në pjesën narrative të raportit:


Treguesit e Indeksit të Sigurisë së Gazetarëve	Raport narrativ
I. Mjedisi ligjor dhe organizativ	
Dispozitat ligjore në lidhje me shpifjen dhe zbatimin e tyre nuk krijojnë efekte frikësuese ndaj gazetarëve dhe mediave	A.6
Besueshmëria e burimeve të gazetarëve është e garantuar në legjislacion dhe respektohet nga autoritetet	A.8
Ligjet tjera zbatohen në mënyrë objektive dhe ju mundësojnë gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave të punojnë lirshëm dhe të sigurt	A.7
Gazetarët janë të lirë të ushtrojnë profesionin e tyre dhe të themelojnë, të bashkohen apo të marrin pjesë në shoqatat e tyre	A.9
Pozita e gazetarëve në vendin e punës është e qëndrueshme dhe e mbrojtur	B.1
II. Parandalimi	
Gazetarët dhe aktorët tjerë mediatik kanë qasje në masat e shpejta dhe efektive mbrojtëse kur ekspozohen ndaj kërcënimeve	C.1
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave (jeta ose integriteti fizik i të cilëve është realisht në rrezik të drejtpërdrejtë) kanë qasje në mekanizma të veçantë për mbrojtje/siguri	C.2
Gazetarët femra kanë qasje në masat ligjore dhe mekanizmat mbështetëse kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore	C.3
Është vendosur praktikë e dënimit të rregullt publik të rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave	C.4
Zyrtarët policor janë të ndjeshëm në çështjen e mbrojtjes së gazetarëve	C.5
III. Procesi	
Njësitë dhe/ose zyrtarët e specializuar hetimorë janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve	C.6
Hetimet për sulmet e rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë mediatik zhvillohen me efikasitet (në mënyrë të pavarur, rrënjësore dhe të shpejtë)	C.7
Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen në mënyrë efektive nga forma të ndryshme të ngacimit në internet	C.8
Hetimet për të gjitha llojet e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve tjerë të mediave zhvillohen në mënyrë transparente	C.9
Nga organet shtetërore janë vendosur sistemet për grumbullimin e të dhënave statistikore cilësore për parandalimin e mosndëshkimit	C.10
IV. Siguria reale	
Kërcënimet dhe ngacimet që nuk kanë të bëjnë me sigurinë fizike	C.11
Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve	C.12
Sulmet e realja	C.13
Kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarisë	C.14



	2024	2025		Ndryshimet e reja kryesore për secilin dimension
Mjedisi ligjor dhe organizativ	3.48	3.47	↓	Mjedisi i lirisë së mediave në Kosovë u përkeqësua pak për shkak të pasigurisë ligjore rreth KPM-së dhe presionit të shtuar publik gjatë vitit zgjedhor. Gjykata Kushtetuese anuloi ligjin e ndryshuar të KPM-së, duke konfirmuar shqetësimet në lidhje me pavarësinë rregullatore dhe mbikëqyrjen e mundshme shtetërore të medias online. Gjersa korniza ligjore mbetet përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, zbatimi i dobët, procedurat e gjata dhe barrat financiare vazhdojnë të dekurajojnë gazetarët nga kërkimi i mbrojtjes ligjore.
Parandalimi i duhur	3.24	3.23	↓	Mekanizmat parandalues mbetën të mangët në vitin 2025. Edhe pse AGK vazhdoi bashkëpunimin me policinë, prokurorinë, gjykatat dhe partnerët ndërkombëtarë, nuk u krijua asnjë protokoll formal apo mekanizëm i linjës së ndihmës për reagime të shpejta ndaj kërcënimeve. Parandalimi ende varet kryesisht nga komunikimi ad hoc, angazhimi individual institucional dhe ndërhyrja e drejtpërdrejtë e AGK-së, sesa nga një sistem i qëndrueshëm dhe i institucionalizuar.
Procesi i rregullt	3.24	3.24	–	Procesi i rregullt ligjor tregoi përparim të kufizuar, ndërsa vonesat dhe mospërputhjet vazhduan. Gazetarët vazhduan të përballen me procedura të gjata në rastet e kërcënimeve, sulmeve, shkeljeve të rregullave të punës dhe ngacmimit në internet. Edhe pse disa institucione iu përgjigjën kërkesave të AGK-së, hetimet dhe procedurat gjyqësore mbetën të ngadalta, duke dobësuar besimin në mekanizmat mbrojtës dhe duke kufizuar llogaridhënien për shkeljet kundër gazetarëve.
Siguria aktuale	2.28	2.55	↑	Siguria aktuale e gazetarëve mbeti e brishtë në vitin 2025. Ata vazhduan të përballen me kërcënime fizike, sulme verbale, ngacmime online, abuzim me bazë gjinore, fushata shpifjesh dhe presion të lidhur me zhvillimet politike. Gratë gazetare ishin veçanërisht të ekspozuara ndaj sulmeve mizogjine dhe dezinformimit gjinor. Përgjigja e kufizuar institucionale tregon se rreziqet e sigurisë mbeten fizike, digjitale, ligjore, ekonomike dhe psikologjike.
Indeksi i sigurisë së gazetarëve	2.80	2.93	↑	



Mjedisi ligjor dhe organizativ



TREGUESI 1.1

— DISPOZITAT LIGJORE QË LIDHEN ME SHPIFJEN DHE ZBATIMI I TYRE NUK PRODHOJNË EFEKTE DEKURAJUESE PËR GAZETARËT DHE MEDIAT

Rezultati për vitin 2024: 3.40 /
Rezultati për vitin 2025: 3.38

Situata është përkeqësuar pak në vitin 2025. Kjo rënie e vogël pasqyron përdorimin e vazhdueshëm ose kërcënimin me padi për shpifje, të kombinuara me retorikë më të fortë publike nga akterët politikë gjatë një viti të karakterizuar nga zgjedhjet, gjë që kontriboi në presionin indirekt mbi gazetarët dhe mediat. Edhe pse shpifja mbetet e rregulluar brenda një kornize përgjithësisht të përafuar me standardet evropiane, barra praktike e mbrojtjes së rasteve të tilla mbetet e konsiderueshme. Procedurat e gjata gjyqësore, kostot ligjore dhe presioni mbi reputacionin vazhdojnë të dekurajojnë raportimin investigativ, veçanërisht mbi korrupsionin, keqpërdorimin e fondeve publike dhe temat politikisht të ndjeshme.

TREGUESI 1.2

— KONFIDENCIALITETI I BURIMEVE TË GAZETARËVE GARANTOHET NË LEGJISLACION DHE RESPEKTOHET NGA AUTORITETET

Rezultati për vitin 2024: 4.18 / Rezultati për vitin 2025: 4.18

Situata ka mbetur e qëndrueshme në vitin 2025. Ky stabilitet pasqyron praninë dhe respektin e vazhdueshëm të mbrojtjeve të forta ligjore për konfidencialitetin e burimeve gazetareske, pa raste të raportuara të autoriteteve që i detyrojnë gazetarët të zbulojnë burimet e tyre gjatë periudhës së raportimit. Këto masa mbrojtëse mbeten veçanërisht të rëndësishme për gazetarët investigativë që punojnë në korrupsion, krim të organizuar, llogaridhënie institucionale dhe çështje të tjera të ndjeshme me interes publik. Rezultati i pandryshuar tregon se, pavarësisht presioneve më të gjera mbi mjedisin mediatik, mbrojtja e burimeve vazhdon të jetë një nga garancitë më të forta në kuadrin ligjor të Kosovës.

TREGUESI 1.3

— LIGJET E TJERA ZBATOHEN NË MËNYRË OBJEKTIVE DHE U MUNDËSOJNË GAZETARËVE DHE AKTERËVE TË TJERË TË MEDIAVE TË PUNOJNË LIRSHËM DHE NË MËNYRË TË SIGURT

Rezultati për vitin 2024: 2.88 /
Rezultati për vitin 2025: 2.88

Situata ka mbetur kryesisht e pandryshuar në vitin 2025. Megjithatë, rezultati më i ulët pasqyron shqetësimin e vazhdueshëm se mjedisi ligjor nuk i mbron mjaftueshëm gazetarët nga veprimet ligjore abuzive, veçanërisht në mungesë të legjislacionit specifik anti-SLAPP. Gjersa nuk u raportua asnjë zbatim sistematik arbitrar i ligjeve, paditë e përsëritura dhe kërcënimet ligjore kundër gazetarëve vazhdojnë të krijojnë presion financiar, profesional dhe

psikologjik. Kjo është veçanërisht e dukshme në raportimin mbi korrupsionin, zyrtarët publikë, ndikimin politik dhe interesat e fuqishme private, ku veprimet ligjore mund të përdoren për të frikësuar ose shteruar aktorët e medias.

TREGUESI 1.4

— GAZETARËT JANË TË LIRË TË USHTROJNË PROFESIONIN E TYRE DHE TË THEMELONJË, T'U BASHKOHEN DHE TË MARRIN PJESË NË SHOQATAT E TYRE

Rezultati për vitin 2024: 3.90 /
Rezultati për vitin 2025: 3.90

Situata ka mbetur e qëndrueshme në vitin 2025. Përmirësimi i lehtë pasqyron mungesën e vazhdueshme të kufizimeve ligjore ose administrative që i pengojnë gazetarët të ushtrojnë profesionin e tyre ose të krijojnë, bashkohen dhe marrin pjesë në shoqata profesionale. AGK dhe organizata të tjera të lidhura me mediat vazhduan të veprojnë lirisht, të përfaqësojnë gazetarët, të reagojnë publikisht ndaj shkeljeve dhe të angazhohen me institucionet dhe partnerët ndërkombëtarë. Megjithatë, kjo liri formale mbetet e prekur nga sfida më të gjera strukturore, duke përfshirë presionin politik, mbrojtjen e dobët të punës, pasigurinë ekonomike dhe qasjen e pabarabartë në mbështetje profesionale, veçanërisht për gazetarët jashtë qendrave kryesore mediatike.

TREGUESI 1.5

— POZITA E PUNËS SË GAZETARËVE ËSHTË E QËNDRUESHME DHE E MBROJTUR NË VENDIN E PUNËS

Rezultati për vitin 2024: 3.04 / Rezultati për vitin 2025: 3.02

Situata është përkeqësuar pak në vitin 2025. Kjo rënie e vogël pasqyron vazhdimësinë e kushteve të pasigurta të punësimit, veçanërisht në mediat më të vogla private, ku gazetarët shpesh punojnë sipas marrëveshjeve informale, kontratave afatshkurtra, pagesave të vonuara ose mekanizmave të dobët të mbrojtjes së brendshme. Mungesa e një sindikate të fortë gazetarësh në të gjithë sektorin vazhdon të kufizojë negociatat kolektive dhe i lë shumë gazetarë të varur nga negociatat individuale me punëdhënësit. Shkeljet e të drejtave të punës, frika nga pushimi nga puna dhe qasja e kufizuar në mjete juridike mbeten shqetësime të rëndësishme, veçanërisht për gazetarët e rinj, gazetarët gra dhe punonjësit e medias në pozicione më pak të sigurta.



Parandalimi i duhur

Gazetarët dhe aktorët e medias kanë akses te masat e menjëhershme dhe efektive mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar

3.41

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të medias (jeta ose integriteti fizik i të cilëve janë në rrezik real dhe të menjëhershëm) kanë akses te mekanizmat specifikë...

3.34

Gazetare gra kanë akses te masat ligjore dhe mekanizmat e mbështetjes kur përballen me kërcënime, ngacmime dhe dhunë me bazë gjinore

3.22

Është krijuar praktika e rregullt e dënimit publik të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave

2.54

Organet e policisë janë të ndjeshme ndaj çështjes së mbrojtjes së gazetarëve

3.64

- 1.00 Nuk ka mekanizma institucionale për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve. Zyrtarët inkurajojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe autoritetet policore i trajtojnë gazetarët jashtëzakonisht ashpër.
- 2.00
- 3.00
- 4.00 ↑
- 5.00 ↓
- 6.00
- 7.00 Të gjithë mekanizmat institucionale janë të krijuar për mbrojtjen e menjëhershme të gazetarëve në rast sulmi, zyrtarët në mënyrë të qartë dhe sistematike dekurajojnë sulmet ndaj gazetarëve dhe autoritetet policore i trajtojnë gazetarët me respekt.

TREGUESI 2.1

— GAZETARËT DHE AKTERËT E MEDIAS KANË QASJE NË MASA MBROJTËSE TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE KUR KËRCËNOHEN

Rezultati për vitin 2024: 3.41 / Rezultati për vitin 2025: 3.41

Situata mbeti kryesisht e pandryshuar në vitin 2025. Kjo pasqyron mungesën e vazhdueshme të një mekanizmi mbrojtës të dedikuar dhe të institucionalizuar për gazetarët, pavarësisht numrit të lartë të kërcënimeve, sulmeve dhe rasteve të frikësimit të raportuara gjatë vitit. Ndërsa gazetarët mund t'i raportojnë rastet në polici dhe ofrohen disa përgjigje institucionale, këto masa nuk janë sistematike, të shpejta ose të përshtatura posaçërisht për nevojat e punonjësve të mediave. Mbrojtja ende varet kryesisht nga serioziteti i secilit rast individual, reagimi i zyrtarëve specifikë dhe ndërhyrja e AGK-së në dokumentimin, reagimin ndaj dhe ndjekjen e kërcënimeve të raportuara.

TREGUESI 2.2

— GAZETARËT DHE AKTERËT E TJERË TË MEDIAVE (JETA OSE INTEGRITETI FIZIK I TË CILËVE ËSHTË NË RREZIK REAL DHE TË MENJËHERSHËM) KANË QASJE NË MEKANIZMA TË POSAÇËM MBROJTJEJE/SIGURIE

**Rezultati për vitin 2024: 3.34 /
Rezultati për vitin 2025: 3.34**

Situata mbeti e pandryshuar në vitin 2025. Kosova ende mbështetet kryesisht në masat e përgjithshme të mbrojtjes policore, pa një sistem të specializuar sigurie të projektuar për gazetarët dhe punonjësit e medias që përballen me rrezeqe serioze ose të menjëhershme. Edhe pse rastet urgjente mund të marrin vëmendjen e policisë, nuk ka një mekanizëm të strukturuar që siguron vlerësimin e rrezikut, reagimin e shpejtë, ndjekjen dhe koordinimin midis policisë, prokurorisë, gjykatave dhe organizatave mediatike. Si rezultat, mbrojtja mbetet reaktive dhe sipas rastit, në vend që të jetë parandaluese, e standardizuar dhe e bazuar në rreziqet specifike me të cilat përballen gazetarët kur raportojnë për çështje të ndjeshme, protesta, tensione politike ose krim të organizuar.

TREGUESI 2.3

— GRATË GAZETARE KANË QASJE NË MASA LIGJORE DHE MEKANIZMA MBËSHTETËS KUR PËRBALLEN ME KËRCËNIME, NGACMIME DHE DHUNË ME BAZË GJINORE

Rezultati për vitin 2024: 3.24 / Rezultati për vitin 2025: 3.22

Situata është përkeqësuar pak në vitin 2025. Kjo rënie e vogël pasqyron vazhdimësinë e kërcënimeve me bazë gjinore, ngacmimeve online, gjuhës mizogjine dhe fushatave të koordinuara të shpifjes që synojnë gratë gazetare, veçanërisht ato që raportojnë për politikën, korrupsionin, barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut. Edhe pse formalisht ekzistojnë mbrojtje ligjore dhe kanale raportimi, zbatimi mbetet i paqëndrueshëm dhe shumë gra gazetare ende hezitojnë të raportojnë rastet për

shkak të besimit të ulët në institucione, frikës nga ekspozimi i mëtejshëm ose përvojave të mëparshme të ndjekjes joadekuate. Mekanizmat mbështetës mbeten të fragmentuar dhe jo mjaftueshëm të ndjeshëm ndaj ndikimit specifik digjital, psikologjik dhe profesional të sulmeve me bazë gjinore.

TREGUESI 2.4

— ËSHTË VENDOSUR PRAKTIKA E DËNIMIT TË RREGULLT PUBLIK TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE DHE MEDIAVE.

Rezultati për vitin 2024: 2.63 /
Rezultati për vitin 2025: 2.54

Situata është përkeqësuar ndjeshëm në vitin 2025. Kjo rënie lidhet me rritjen e retorikës armiqësore kundër gazetarëve dhe mediave, veçanërisht gjatë periudhës zgjedhore dhe në debatet politikisht të ndjeshme, të kombinuara me mungesën e dënimit të qëndrueshëm dhe të qartë nga zyrtarët publikë. Në disa raste, sulmet ose presioni ndaj gazetarëve ose u injoruan, u minimizuan ose u shoqëruan me gjuhë që vuri më tej në pikëpyetje besueshmërinë e mediave. Një diskurs i tillë kontribon në normalizimin e frikësimit, dobëson besimin e publikut në gazetari dhe krijon një mjedis ku kërcënimet, sulmet verbale dhe fushatat e shpifjes kanë më pak gjasa të trajtohen si shkelje serioze.

TREGUESI 2.5

— AUTORITETET POLICORE JANË TË NDJESHME NDAJ ÇËSHTJES SË MBROJTJES SË GAZETARËVE

Rezultati për vitin 2024: 3.60 /
Rezultati për vitin 2025: 3.64

Situata është përmirësuar pak në vitin 2025. Ky përmirësim pasqyron bashkëpunimin në rritje midis Policisë së Kosovës, AGK-së, OSBE-së dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë komunikim më të rregullt, iniciativa trajnimi dhe diskutime mbi sigurinë e gazetarëve gjatë protestave, ngjarjeve publike dhe mjediseve të tensionuara të raportimit. Reagimi i policisë në disa raste të raportuara është përmirësuar dhe ka një ndërgjegjësim më të madh për nevojën për t'i trajtuar sulmet ndaj gazetarëve si një çështje sigurie profesionale, jo vetëm si incidente të zakonshme. Megjithatë, mungesa e protokolleve formale, kanaleve të qarta të komunikimit dhe procedurave të specializuara do të thotë që përgjigjet ende varen nga zyrtarët individualë dhe ende nuk janë plotësisht të qëndrueshme në të gjitha rajonet.



Procesi i rregullt

Njësitë dhe/ose oficerët e investigimit të specializuara janë të pajisur me ekspertizën përkatëse për hetimin e sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve

3.68

Hetimet për sulme të rënda fizike ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë efikase (të pavarur, të plotë dhe të menjëhershme)

2.97

Gazetarët dhe aktorët e tjerë të mediave mbrohen me efikasitetet nga format e ndryshme të ngacmimeve online

2.80

Hetimet e të gjitha formave të sulmeve dhe dhunës ndaj gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave kryhen në mënyrë transparente

3.13

Autoritetet shtetërore krijojnë sisteme cilësore të mbledhjes së statistikave për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë

3.60

1.00

Institucionet nuk hetojnë dhe nuk dënojnë sulmet ndaj gazetarëve, përfshirë ngacmimet në internet, kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve dhe mediave.

2.00

3.00

4.00

5.00

6.00

7.00



Institucionet janë plotësisht efektive dhe transparente në hetimin dhe dënimin e sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë këtu ngacmimet në internet, kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe mediave.

TREGUESI 3.1

— NJËSITË DHE/OSE ZYRTARËT E SPECIALIZUAR TË HETIMIT JANË TË PAJISUR ME EKSPERTIZËN PËRKATËSE PËR HETIMIN E SULMEVE DHE DHUNËS KUNDËR GAZETARËVE

**Rezultati për vitin 2024: 3.66 /
Rezultati për vitin 2025: 3.68**

Situata është përmirësuar pak në vitin 2025. Ky përmirësim i vogël pasqyron një koordinim më të mirë midis AGK-së dhe institucioneve përkatëse, si dhe përdorimin e vazhdueshëm të pikave të kontaktit të caktuara brenda strukturave të policisë dhe prokurorisë për rastet që përfshijnë gazetarë. Këto kanale kanë ndihmuar në përmirësimin e komunikimit, raportimit dhe ndjekjes në disa raste, veçanërisht kur AGK ndërhyr drejtpërdrejt. Megjithatë, Kosova ende nuk ka njësi të specializuara hetimore, protokolle të detyrueshme dhe trajnim sistematik për trajtimin e sulmeve kundër gazetarëve, gjë që kufizon efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe ndjeshmërinë e përgjigjeve institucionale.

TREGUESI 3.2

— HETIMET E SULMEVE TË RËNDA FIZIKE NDAJ GAZETARËVE DHE AKTERËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË EFIKASE (NË MËNYRË TË PAVARUR, TË PLOTË DHE TË SHPEJTË).

Rezultati për vitin 2024: 2.97 / Rezultati për vitin 2025: 2.97

Situata ka mbetur kryesisht e pandryshuar në vitin 2025. Edhe pse rezultati është rritur, hetimet për sulme të rënda fizike vazhdojnë të përballen me vonesa, joefikasitete procedurale dhe vëmendje të kufizuar ndaj kontekstit më të gjerë në të cilin ndodhin sulmet. Rastet shpesh trajtohen si incidente të zakonshme dhe jo si sulme të lidhura me detyrat profesionale të gazetarëve, gjë që mund të dobësojë llogaridhënien dhe parandalimin. Ndërsa hetimet në përgjithësi fillohen, ato nuk kryhen gjithmonë menjëherë, tërësisht ose me transparencë të mjaftueshme, veçanërisht kur sulmet ndodhin gjatë protestave, tensioneve politike ose raportimit mbi çështje të ndjeshme.

TREGUESI 3.3

— GAZETARËT DHE AKTERËT E TJERË TË MEDIAVE MBROHEN NË MËNYRË EFIKASE NGA FORMAT E NDRYSHME TË NGACIMIT NË INTERNET

**Rezultati për vitin 2024: 2.83 /
Rezultati për vitin 2025: 2.80**

Situata është përkeqësuar pak në vitin 2025. Kjo rënie pasqyron intensitetin në rritje të abuzimit online kundër gazetarëve, duke përfshirë ngacmimet e koordinuara, fushatat e shpifjes, kërcënimet, gjuhën mizogjine dhe përpjekjet për të diskredituar raportimin profesional. Gratë gazetare dhe gazetarët që mbulojnë politikën, korrupsionin, barazinë gjinore dhe llogaridhënien publike mbeten veçanërisht të ekspozuara ndaj këtyre sulmeve. Përgjigjet ekzistuese ligjore

dhe institucionale ende nuk janë përshtatur mjaftueshëm ndaj kërcënimeve digjitale, ndërsa procedurat e ngadalta të raportimit, ndjekja e dobët dhe vështirësitë në identifikimin e autorëve vazhdojnë t'i lënë gazetarët pa mbrojtje efektive.

TREGUESI 3.4

— HETIMET E TË GJITHA LLOJEVE TË SULMEVE DHE DHUNËS KUNDËR GAZETARËVE DHE AKTERËVE TË TJERË TË MEDIAVE KRYHEN NË MËNYRË TRANSPARENTE.

Rezultati për vitin 2024: 3.13 / Rezultati për vitin 2025: 3.13

Situata ka mbetur e pandryshuar në vitin 2025. Mekanizmat formalë për komunikim dhe ndarjen e informacionit ekzistojnë, por në praktikë ato zbatohen në mënyrë jokonsistente dhe shpesh varen nga institucionet ose zyrtarët individualë. Gazetarët dhe AGK nuk marrin gjithmonë përditësime me kohë, proaktive ose të detajuara mbi progresin e hetimeve, aktakuzave ose procedurave gjyqësore. Kjo mungesë e një procedure të caktuar për ndjekjen e rasteve e bën të vështirë vlerësimin e performancës institucionale, ndjekjen e rezultateve të rasteve dhe identifikimin e modeleve të pandëshkueshmërisë, veçanërisht në rastet që përfshijnë kërcënime, ngacmime online, sulme fizike dhe presion ndaj punonjësve të medias.

TREGUESI 3.5

— EKZISTOJNË SISTEME CILËSORE TË MBLEDHJES SË STATISTIKAVE NGA AUTORITETET SHTETËRORE PËR TË NDALUAR PANDËSHKUESHMËRINË

**Rezultati për vitin 2024: 3.60 /
Rezultati për vitin 2025: 3.60**

Situata ka mbetur e pandryshuar në vitin 2025. Autoritetet shtetërore vazhdojnë të mbledhin disa të dhëna mbi rastet që përfshijnë gazetarë, por sistemi mbetet i fragmentuar në polici, prokurori, gjykata dhe institucione të tjera përkatëse. Mungesa e bazave të të dhënave të harmonizuara dhe të dhënat e ndara vazhdimisht sipas llojit të sulmit, gjinisë, profesionit, rezultatit dhe reagimit institucional kufizon aftësinë për të matur me saktësi pandëshkueshmërinë. Si rezultat, përgjigjet e politikave mbeten më pak të bazuara në prova, ndërsa monitorimi i pavarur i AGK-së vazhdon të luajë një rol thelbësor në dokumentimin e shkeljeve dhe identifikimin e boshllëqeve në ndjekjen institucionale.

IV.

Siguria aktuale



TREGUESI 4.1

— KËRCËNIMET DHE NGACMIMET QË NUK LIDHEN ME SIGURINË FIZIKE

Kjo mund të përfshijë mbikëqyrje ose përcjellje; ngacmim me telefon; ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ; deklarata agresive nga zyrtarë publikë; lloje të tjera presionesh që kërcënojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre. Këto lloje kërcënimesh nuk përfshijnë ngacmimin nga turma dhe ngacmimin në mjedisin e punës..

Rezultati për vitin 2024: 1.78 / Rezultati për vitin 2025: 1.98

Në vitin 2025 u regjistruan gjithsej 25 kërcënime jo-fizike ndaj gazetarëve, duke përfshirë presion politik, ngacmim online, fushata shpifjesh, deklarata publike agresive dhe përpjekje për të diskredituar punën e medias. Këto forma të frikësimit janë bërë më të shpeshta dhe sistematike, veçanërisht gjatë periudhave të ndjeshme politikisht dhe raportimit që lidhet me zgjedhjet. Edhe pse ato nuk përfshijnë gjithmonë rrezik të drejtpërdrejtë fizik, ato ndikojnë seriozisht në sigurinë profesionale, mirëqenien mendore dhe aftësinë e gazetarëve për të raportuar lirisht, duke kontribuar në një klimë të vazhdueshme frike, autocensure dhe presioni.

TREGUESI 4.2

— KËRCËNIME NDAJ JETËS DHE SIGURISË FIZIKE TË GAZETARËVE

Kjo mund të përfshijë thirrje për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të tyre; thirrje për sulme fizike ndaj gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të tyre. Kërcënimet mund të jenë të drejtpërdrejta ose të dërguara nëpërmjet palëve të treta; të dërguara elektronikisht ose në komunikim të drejtpërdrejtë; ato mund të jenë të nënkuptuara, si dhe të qarta.

Rezultati për vitin 2024: 2.17 / Rezultati për vitin 2025: 2.98

U regjistruan gjithsej 4 incidente, ose 5 më pak se vitin e kaluar. Edhe pse numri i rasteve mbeti relativisht i ulët, incidentet e raportuara përfshinin kërcënime serioze, duke përfshirë kërcënime me vdekje dhe kërcënime për dhunë fizike ndaj gazetarëve për shkak të punës së tyre profesionale. Edhe rastet e izoluara të kësaj natyre kanë një efekt të fortë frenues, pasi krijojnë frikë jo vetëm për gazetarët e synuar, por edhe për kolegët, familjet dhe burimet e tyre. Prania e vazhdueshme e kërcënimeve të tilla tregon se gazetarët mbeten të ekspozuar kur raportojnë për çështje të ndjeshme politike, sociale ose penale, edhe kur numri i përgjithshëm i rasteve është i kufizuar.

TREGUESI 4.3

— SULMET AKTUALE

Kjo mund të përfshijë dëmtim fizik ose mendor, rrëmbim, hyrje e paautorizuar në shtëpi/zyrë, konfiskim të pajisjeve, ndalim arbitrar, përpjekje të dështuara për vrasje, etj.

Rezultati për vitin 2024: 2.64 / Rezultati për vitin 2025: 2.71

Në vitin 2025 ndodhën gjithsej 13 incidente, që është numër shumë më i ulët krahasuar me vitin 2023 kur u regjistrua numri më i madh i sulmeve (20) në 6 vitet e fundit. Incidentet e raportuara përfshinin frikësim, ndërhyrje në raportim, pengim të lëvizjes ose filmimit dhe veprime të tjera që ndikuan drejtpërdrejt në aftësinë e gazetarëve për të punuar në mënyrë të sigurt. Dinamika politike luajti një rol kyç në ekspozimin e gazetarëve ndaj rreziqeve më të mëdha, veçanërisht kur punonjësit e mediave raportuan nga mjedise të polarizuara ose sfiduan akterët politikë, institucionet dhe grupet e interesit.

TREGUESI 4.4

— KËRCËNIME DHE SULME NDAJ MEDIAVE DHE SHOQATAVE TË GAZETARËVE

Kërcënimet mund të përfshijnë thirrje telefonike ngacmuese, ngacmim arbitrar gjyqësor ose administrativ, deklarata agresive nga zyrtarët publikë dhe forma të tjera të presionit (mbishkrime, postime kërcënuese, etj.). Sulmet aktuale përfshijnë hyrjen e paautorizuar në zyra, sekuestrimin e pajisjeve, thyerjen e pajisjeve, automjeteve, etj.

Rezultati për vitin 2024: 2.52 / Rezultati për vitin 2025: 2.53

Situata mbeti pothuajse e ngjashme në vitin 2025. Ky ndryshim i vogël pasqyron presionin e vazhdueshëm ndaj mediave dhe shoqatave të gazetarëve, duke përfshirë sulmet kibernetike, dëmtimet fizike, retorikën armiqësore publike dhe shënjestrimin politik të institucioneve mediatike. Presioni drejtohet gjithnjë e më shumë jo vetëm ndaj gazetarëve individualë, por edhe ndaj redaksive, platformave mediatike dhe organizatave përfaqësuese që mbrojnë të drejtat e gazetarëve. Sulme të tilla minojnë qëndrueshmërinë institucionale, dobësojnë besimin publik në median e pavarur dhe krijojnë barrë shtesë operative dhe financiare për mediat që tashmë përballen me paqëndrueshmëri ekonomike dhe presion politik.

Titulli origjinal
KOSOVË
Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe
Indeksi i Sigurisë së Gazetarëve 2025

Botuesi
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Prishtinë, 2026



Autor(ë)
Getoarbë Mulliqi

Recenzentët
Abit Hoxha
Yll Zekaj

Asistente hulumtuese
Artiola Babuni

Përkthyer nga
Anyla Zajmi

Foto e kopertinës
Andrija Vukelić

Dizajni
comma.rs



Ky publikim është zhvilluar me mbështetje
financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja
e tij është përgjegjësi vetëm e autorit
dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht
pikëpamjet e Bashkimit Evropian.